

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**UDHËZUES KURRIKULAR**  
**(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)**

**LËNDA:GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

**TIRANË, GUSHT 2010**

**AUTOR:**  
**ANTONETA RAMA**  
**LINDITA MURTHI**

*Gjuha shqipe dhe letërsia është themeli i procesit të të nxënit, i komunikimit, i formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe i krijimit të marrëdhënieve shoqërore.*

## **PËRMBAJTJA**

### **1.Rëndësia e gjuhës shqipe dhe e letërsisë në kurrikulën e re**

#### **1.1.Synimet e kurrikulës së re**

#### **1.2.Zhvillimi i aftësive**

#### **1.3. Mundësitë kurrikulare për integrimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë me lëndët dhe fushat e tjera.**

#### **1.4.Objektiva të arritjes**

#### **1.5.Objektiva specifike të arritjes të shkruarit në kurrikulën bërthamë të gjuhës shqipe dhe letërsisë,klasa e 10.**

### **2.Metodologjia për zhvillimin e lëndës**

### **3.Vlerësimi i nxënësit**

## 1. RËNDËSIA E GJUHËS SHQIPE DHE E LETËRSISË NË KURRIKULËN E RE

Kurrikula e re mbështetet në *parimin* që gjuha dhe letërsia përbëjnë themelet në procesin e të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore. Ajo është ngritur mbi bazën e *parimit* të integritetit të gjuhës shqipe dhe letërsisë, si dhe të *parimit* të rimarrjes së njohurive, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

Kjo lëndë studion artin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit duke u përqëndruar në tekste letrare, joletrare dhe pamore.

Misioni i lëndës është që të pasurojë përvojat dhe interesat në përdorimin e gjuhës e të letërsisë. Nxënësi, i ndërgjegjshëm për fuqinë që ka gjuha dhe letërsia në jetën e tij, e përdor atë në forma të ndryshme. Për rrjedhojë, ai do të *përballet* me të gjitha format e produkteve të shkruara (tekstin tregimtar, poetik, dramatik, shpjegues, përshkrues, argumentues/bindës dhe informativ) si dhe me format e produkteve mediatike. Nxënësi mëson t'i trajtojë këto produkte si tekste që mund të kuptohen dhe të ndërtohen. Nëpërmjet gjuhës shqipe dhe letërsisë nxënësi njihet e përvetëson kulturën e vendit të tij, si dhe formon identitetin personal e kombëtar. Zhvillimi i interesit të nxënësit për letërsinë, lidhja me të, dialogimi, kuptimi e vlerësimi kritik i letërsisë e llojeve të tjera të produkteve gjuhësore janë boshte kryesore të kësaj lënde.

Gjuha shqipe dhe letërsia zgjeron njohuritë dhe zhvillon aftësitë e domosdoshme, që nxënësi të jetë i suksesshëm në të gjitha fushat e kurrikulës. Mësimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë realizohet përmes gjithë procesit mësimor-edukativ, në të cilin njohuritë e fituara brenda dhe jashtë

shkollës sistemohen dhe përmirësohen, duke rritur shkallën e vështirësisë dhe të përvetësimit të tyre.

### 1.1.Synimet e kurrikulës së re

Lënda ka për synim të zhvillojë tek nxënësi:

- a. të lexuarit dhe të shkruarit e logjikshëm dhe kritik, për ta përgatitur atë që të ndërmarrë sfida dhe përgjegjësi gjatë jetës në të gjitha kontekstet;
- b. respektin dhe vlerësimin për përdorimin e gjuhës së shkruar, jo të shkruar dhe të folur në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme;
- c. vetëdijen për vlerat e teksteve në format e shumta të tyre për të pasuruar perceptimet, për të rritur kuptimin e identitetit kulturor dhe për të krijuar përvoja të kënaqësisë estetike.

Gjuha shqipe dhe letërsia do të orientojë nxënësin drejt përvetësimit aktiv të informacionit, procesit kritik dhe interpretimit të informacionit nëpërmjet:

- a. **Koncepteve dhe procesit**, si aftësi për të menduar, për të arsyetuar, për të dalluar dhe për të vlerësuar në një shumëllojshmëri të konteksteve gjuhësore, personale, sociale, profesionale dhe kulturore.
- b. **Njohurive dhe përmbajtjes**, si njohuri rreth natyrës dhe përdorimit të gjuhës; shumëllojshmërisë së funksioneve dhe zhanreve me të cilat ajo vepron. Në këtë kontekst, gjinitë dhe llojet letrare që do të përdoren duhet të jenë nga më të rëndësishmet si në letërsinë shqiptare ashtu dhe në letërsinë botërore.

- a. **Aftësive**, si të interpretuarit dhe të krijuarit të veçorive të tekstit (gramatikë, shqiptim, paragraf...) të gjuhës së shkruar dhe të folur.
- c. **Qëndrimeve dhe vlerave**, si:
- zhvillimi i interesit dhe kënaqësia në përdorimin e gjuhës;
  - respekti për mundësitë e gjuhës për të krijuar kuptimin;
  - vlerësimi për shfaqjet e veta të ndryshme kulturore

### Struktura e lëndës

Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të zhvillojë:

- a) *të kuptuarit*; nxënësi duhet të analizojë, të nxjerrë përfundime, të sintetizojë dhe të vlerësojë;
- a) *të krijuarit*; nxënësi duhet të kërkojë, të planifikojë, të skicojë, të riskicojë dhe të redaktojë,

duke trajtuar të gjitha format e produkteve gjuhësore të tilla, si:

- tekste të gjuhës së folur,
- tekste të gjuhës së shkruar,
- tekste të gjuhës vizuale.

*Koncepti i të modeluarit është mjaft i rëndësishëm.* Kjo do të thotë që gjatë *të kuptuarit*, nxënësi do të shohë sesi gjuha ndërton, formon, modelon përvoja nëpërmjet stilit, gjinive e kontekstit. Gjatë *të krijuarit*, nxënësit do t'i jepen mundësi që, nëpërmjet gjuhës, të krijojnë përvojën e vet. **Integrimi i të kuptuarit dhe i të krijuarit është i domosdoshëm gjatë të mësuarit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.**

Është e domosdoshme të theksohet se mësimi i gjuhës dhe i letërsisë bëhet mbi të gjitha nëpërmjet rritjes së kompleksitetit të veprave dhe të teksteve me të cilat do të përballet nxënësi/i,-ja nga klasa në klasë. **Tekstet janë përzgjedhur në përputhje me zhvillimin emocional dhe**

### **mendor të nxënësve në klasa të ndryshme.**

**Tekstet janë** elementi më i rëndësishëm e i domosdoshëm i lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, pasi nëpërmjet tij do të realizohen gjithë objektivat e programit. **Janë pikërisht këto tekste dhe shkalla e vështirësisë së tyre në rritje, të cilat bëjnë që edhe objektiva të njëjtë në formulim me vitin paraardhës, të trajtohen në nivele dhe mënyra të ndryshme.** Konkretisht objektivi: - të analizojë gjuhën e figurshme të një teksti, merr “vlera” të ndryshme në varësi të llojit të tekstit. Ky ndryshim ndodh jo vetëm kur shkrimtarët u përkasin periudhave e drejtimeve të ndryshme, por edhe kur janë të së njëjtës periudhë e të të njëjtit drejtim letrar, p.sh.: proza e Koliqit dhe e Kutelit; e Kadares dhe e Agollit apo poezia e Shkrelit dhe e Podrimjes; e Reshpes dhe Camajt.

Objektivi: - të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara, është i domosdoshëm për çdo nivel shkollimi. Ky objektivi merr formë të ndryshme realizimi në klasa të ndryshme. Fjalitë e thjeshta në kontekstin e shkrimit të një nxënës/i,-eje në klasën e 6<sup>-të</sup> nuk kanë të njëjtën formë realizimi me fjalitë e thjeshta në shkrimin e një nxënës/i,-eje në klasën e 11<sup>-të</sup> të gjimnazit. Po ashtu, një ese tregimtare e shkruar me aftësitë e plota të një nxënës/i,-eje në klasën e 6<sup>-të</sup> nuk pritet të jetë eseja tregimtare e shkruar me nivelet dhe aftësitë e plota të një nxënës/i,-eje të klasës së 11<sup>-të</sup> të gjimnazit.

E rëndësishme në përvetësimin e aftësive të të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit, të vështuarit është që të kuptohet se:

- a) aftësitë në përdorimin e gjuhës në trajtimin e letërsisë rriten dhe ndërlikohen, në qoftëse gjuha dhe letërsia, gjithnjë e më shumë, përdoren në mënyrat dhe format e tyre komplekse. Për këtë, nxënësit duhet të angazhohen në tekste dhe bashkëbisedime që janë të pasura me ide dhe shprehësi dhe gjithnjë më të vështira në mënyrën se si janë shtjelluar;
- b) përdorimi i gjuhës është një proces aktiv për ndërtimin e domethënies



- a kuptimit; një dëgjues lidh njohuritë e mëparshme për të kuptuar atë që thonë të tjerët;
- c) gjuha zhvillohet në një kontekst shoqëror dhe kulturor. Megjithëse ne e përdorim gjuhën për qëllime dhe veprimtari personale, ky proces lidhet edhe me të tjerët, duke u shndërruar kështu një akt ndërpersonal. Ne jemi dëgjues aktivë për ata që krijojnë tekstet e shkruara, të folura dhe vizuale; të tjerët dëgjojnë mendimet tona dhe lexojnë shkrimet tona;
- d) nxënësit realizojnë të nxënit jo duke i shtuar aftësitë një nga një në “bagazhin” e tyre, por nga përdorimi dhe zbulimi i gjuhës në përmasat e saj të shumta.

Aftësimi i të lexuarit të rrjedhshëm dhe të shkruarit të përshtatshëm është një veçori e rëndësishme e lëndës. Nxënësi duhet të lexojë tekste të llojeve të ndryshme në mënyrë që të aftësohet si lexues dhe të përfitojë kënaqësi nga të lexuarit. Përvojat e tij me tekstin duhet të jenë të gjera, duke filluar që nga tekstet poetike e deri tek tekstet joletrare.

Të lexuarit dhe të shkruarit ofrojnë fuqinë për të informuar, për të përcjellë dije, si dhe për të krijuar një lloj ure midis kohës dhe vendndodhjes. Për shembull, interpretimi dhe krijimi i teksteve letrare e ndihmon nxënësin të kuptojë brezat paraardhëse, si dhe të marrë pjesë e të kontribuojë në ndërtimin dhe përcjelljen e trashëgimisë kulturore.

Gjuha shqipe dhe letërsia mundëson ndërlidhjen midis kësaj lënde dhe lëndëve të tjera të kurrikulës, si: historia, shkencat sociale, matematika, shkencat natyrore etj. Duke kuptuar dhe ndërtuar tekstet letrare dhe joletrare, nxënësi zbulon ndërlidhjet midis tyre.

Aftësimi i të folurit, të dëgjuarit dhe të vështuarit përbëjnë një veçori tjetër të kësaj lënde. Aftësia për të shprehur idetë jo vetëm me shkrim, por edhe me gojë në mënyrë të organizuar, është një pjesë shumë e rëndësishme e këtij programi. Po ashtu, zbulimi, interpretimi, analiza

dhe vlerësimi i argumenteve të tjerëve nëpërmjet të dëgjuarit dhe të vështruarit është proces kyç i të reflektuarit. Nxënësi duhet të shprehë opinionin e tij dhe të angazhohet në procesin e të reflektuarit dhe të të arsyetuarit.

Zhvillimi i aftësisë dalluese dhe interpretuese të nxënësit në lidhje me media të ndryshme, si dhe inkurajimi për të paraqitur produkte krijuese janë elemente të rëndësishme të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë.

*Në përfundim*, Gjuha shqipe dhe letërsia përcjell tek nxënësi një sistem dijesh koherente, të përgjithësuara e bashkëkohore, të cilat mundësojnë njohjen, përdorimin dhe mbajtjen e qëndrimit ndaj pasurisë së gjuhës shqipe dhe shprehjes së saj në tekste dhe vepra nga më përfaqësueset në kulturën shqiptare dhe më gjerë.

## **Përmbajtja e kurrikulës me zgjedhje: Letërsi**

### **Klasa 10**

#### **Orë mësimore: 72 orë**

Studimi i letërsisë, në një kuptim më të ngushtë, konkret dhe specifik, ka vlera thelbësore për formimin dhe zhvillimin e aftësive njohëse dhe krijuese të nxënësit, pasi e ballafaqon me përvoja, rrethana, personazhe, vende, kohë dhe ngjarje që mund të jenë krejt të ndryshme nga përvoja e tij e përditshme.

Ajo kërkon nga nxënësi të reflektojë për domethënien e vlerave kulturore dhe për aspektet kryesore të shoqërisë njerëzore, për të menduar dhe për të diskutuar tematika që janë thelbësore dhe universale.

Gjithashtu, lënda i jep nxënësit mundësinë për të kuptuar më mirë vetveten, për të kuptuar raportin e tij ndaj shoqërisë dhe botës që e rrethon, teksa imagjimon rrethanat, ndodhitë, karakteret e personazheve të veprave letrare etj. Duke studiuar veprat letrare, nxënësi kupton gjithnjë e më mirë sesi

krijuesit e tyre përdorin gjuhën për të krijuar efekte emocionale estetike, si: meditimi, heroikja, e madhërishmja, patosi, humori, ankthi, etj. Me anë tjetër studimi i veprave letrare bën të mundur zbërthimin e përmbajtjes në disa nivele kuptimore.

Duke studiuar veprat e krijuesve më në zë, nxënësi zhvillon aftësitë njohëse, analizuuese, përgjithësuese dhe krijuese.

Lënda e letërsisë krijon mjedisin e domosdoshëm për t'i mësuar nxënësit artin e komunikimit në klasë.

Lënda me zgjedhje është e detyrueshme për nxënësin që e zgjedh. Programi zbatohet nëpërmjet dy moduleve me të njëjtën tematikë: *“Bota dhe ndryshimi”*. Kjo tematikë shtjellohet përmes një vepre të letërsisë shqipe dhe një vepre të letërsisë botërore. Nxënësit, përmes zgjedhjes së njërit apo të dy moduleve, i mundësohet formimi letrar që nga leximi, kuptimi, zbërthimi i përmbajtjes së veprës deri tek analiza e plotë e saj, parashtrimi i qëndrimit të pavarur vlerësues, individual apo në grup. Letërsia synon të zhvillojë më tej aftësinë e nxënësit për të analizuar, gjykuar dhe vlerësuar veprën letrare, idetë dhe mesazhet që ajo përcjell, si dhe të nxisë zhvillimin mendor dhe emocional të tij.

## **Klasa 11. Moduli: Bota dhe ndryshimi**

**Orë mësimore: 72 orë**

**Tema qendrore:** Rrënjët e formimit të kombit shqiptar.

(“Lahuta e Malcis”, Gjergj Fishta)

Në këtë modul nxënësit do të eksplorojnë veten dhe shoqërinë shqiptare në raport me rajonin e më gjerë. Çështja shtrohet: “Ç’kuptim kanë shprehjet “Unë jam shqiptar, ne jemi shqiptarë” në këtë botë të ndryshueshme nga epoka në epokë, nga viti në vit, nga çasti në çast?”

Për një mesazh të rëndësishme si “Bota dhe ndryshimi”, pyetja mund të formulohet: “A ka vlerë trashëgimia kulturore, apo gjithçka që lidhet me një komb vendoset me beteja a ngjarje të ngjashme të reklamuar si përcaktuese në histori?” Me fjalë të tjera: “Cilat janë vlerat e “ushqimit” që vjen nga rrënjët dhe të “ushqimit” që vjen prej degëve?”

**Struktura e modulit:** Moduli përbëhet nga pesë njësi mësimore. Secila njësi mësimore trajton një tematikë të caktuar, të zberthyer në nëntematika e çështje mësimore: (1) “Lahuta e Malcis”, aspekti historik; (2) “Lahuta e Malcis”, aspekti mitologjik; (3) “Lahuta e Malcis”, krahasimi me “Këngën e Sprasme të Balës” të Gavril Darës, “Historinë e Skëndërbeut” të Naim Frashërit, “Milosaon” të De Radës, “Te dheu i huaj” të Skiroit, si dhe me vepra të tilla, si: “Iliada” dhe “Odisea”, “Eneida”, “Nibelungët”; (4) “Lahuta e Malcis”, krahasuar me veprat e tjera të Fishtës; dhe (5) Diskutimi përmbyllës: Vendi i “Lahutës së Malcis” në letërsinë shqiptare, vlerësime pro dhe kundër.

### **Vepra që do të lexohet, analizohet dhe diskutohet**

“Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës, poemë epike (epos) me “lëndë” nga historia politike e Shqipërisë në shekullin e 19-të deri në dekadën e parë të shekullit të 20-të, kur u krijua shteti i pavarur.

## **Klasa 12. Kursi: Letërsi dhe kompozim**

### **Orë mësimore: 34 orë**

Programi i letërsisë, lëndë me zgjedhje, është konceptuar rreth një kornize që përfshin qasje bashkëkohore dhe historike ndaj një leximi që ka në qendër autorin, veprën letrare dhe kontekstin e botës. Nxënës/i-ja mëson

që çdo qasje vë theksin tek ndërveprimet që ndodhin midis autorit, veprës, lexuesit dhe kontekstit të botës. Secila qasje përshkruhet me interpretime historike dhe bashkëkohore, por nxënës/i-ja e bazon punën e tij/saj në radhë të parë tek interpretimet bashkëkohore.

*Kursi* synon dhe i mundëson nxënësit të eksplorojë interesat e tij letrare, të zotërojë aftësitë e nevojshme për studim (letrar) tërësor të veprës dhe të zhvillojë më tej aftësitë për :

- për të komunikuar, me shkrim dhe me gojë, në mënyrë të saktë, të përshtatshme dhe efektive;
- për të kuptuar dhe reaguar në mënyrë imagjinare ndaj asaj që dëgjon dhe lexon;
- për të shijuar veprën letrare dhe vlerësuar ndihmesën që ajo jep në rritjen e anës estetike dhe imagjinuese;

**Në thelb të procesit mësimor** është të shprehurit e nxënësit me shkrim dhe me gojë bazuar në lexime dhe shkrime.

Kursi *kombinon studimin* e letërsisë me kompozimin e bazuar në letërsi; *shkrimin* me analizën kritike. Kursi *kërkon* nga nxënës/i-ja shumë lexime dhe shkrime për letërsinë. Marrëdhëniet midis të shkruarit dhe të lexuarit theksohen gjatë gjithë kursit. Duke bërë një numër të konsiderueshëm punësh me shkrim, nxënës/i-ja do të shprehë estetikisht formimin e tij/saj për letërsinë dhe, nëpërmjet tij mjeshtërinë e të shkruarit.

## 1.2 Zhvillimi i aftësive

Të gjithë nxënësit duhet të zotërojnë disa aftësi në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë, të cilat do t'u duhen për të zgjeruar dhe për të thelluar njohuritë e tyre për lëndën. Këto aftësi i japin përparësi zhvillimit të:

lexuarit, të shkruarit, të vështruarit, të dëgjuarit dhe të folurit.

### **Kompetenca**

Nxënës/i,-ja duhet:

- të jetë i qartë, koherent dhe i saktë në komunikimin me gojë dhe me shkrim;
- të lexojë një shumëllojshmëri tekstesh dhe të reagojë ndaj tyre në mënyrën e duhur;
- të demonstrojë se i ka kuptuar qartë të gjitha rregullat e gjuhës së shkruar, duke përfshirë këtu gramatikën, drejtshkrimin dhe pikësimin;
- të veprojë në një shumëllojshmëri kontekstesh brenda dhe jashtë klasës;
- të marrë vendime të informuara mbi mënyrën e komunikimit me shkrim dhe me gojë.

### **Krijimtaria (të krijuarit/ të ndërtuarit)**

Nxënës/i,-ja duhet:

- të lidhë idetë, përvojat, tekstet dhe fjalët në mënyrë origjinale me njëra-tjetrën, duke u mbështetur mbi një përvojë të pasur nga letërsia dhe gjuha;
- të përdorë teknika të reja në krijimin e kuptimshmërisë, në përdorimin e gjuhës për të krijuar efekte të reja;
- të përdorë imagjinatën për të përçuar tema, ide dhe argumente, për të zgjidhur probleme, për të krijuar rrethana, personazhe dhe gjendje fizike e emocionale;
- të përdorë teknika krijuese për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të zgjidhur probleme dhe për të trajtuar e zhvilluar ide.

### **Të menduarit kritik**

Nxënës/i,-ja duhet:

- të përfshihet me tekste dhe ide për të kuptuar çështjet kryesore që ngrenë këto të fundit;
- të përfshihet me tekste dhe ide për t'iu përgjigjur çështjeve kryesore që ngrenë këto të fundit;
- të vlerësojë vlefshmërinë dhe rëndësinë e informacionit dhe ideve nga burime të ndryshme;
- të zbulojë idetë e të tjerëve duke i zhvilluar më tej ato;
- të analizojë gjuhën e shkruar dhe të folur, për të mësuar sesi krijohet kuptimi/kuptimshmëria;
- të vlerësojë gjuhën e shkruar dhe të folur, për të mësuar sesi krijohet kuptimi/kuptimshmëria.

### **Ndërgjegjësimi kulturor**

Nxënës/i,-ja duhet:

- të njohë trashëgiminë kulturore nëpërmjet teksteve më të rëndësishme të saj;
- të zbulojë sesi idetë, përvojat dhe vlerat janë përfaqësuar jo vetëm në tekstet e kulturës shqiptare, por edhe të kulturave të huaja;
- të kuptojë sesi shqipja ndryshon nga krahina në krahinë apo edhe nga diaspora në diasporë, duke treguar se këto variacione të gjuhës lidhen me identitetin dhe me diversitetin kulturor.

### **1.3 Mundësitë kurrikulare për integrimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë me lëndët dhe fushat e tjera**

#### **Të lexuarit**

Kurrikula duhet t'i ofrojë nxënësit mundësitë e mëposhtme:

- të krijojë (të zhvillojë) pavarësi në të lexuar;
- të përfshihet me tekste të plota për një periudhë kohore të gjatë;
- të zhvillojë aftësitë e të lexuarit nëpërmjet teksteve që lidhen me fushat e tjera të dijes;
- të flasë, brenda mundësive, me lexues dhe shkrimtarë të tjerë;
- të përshihet në aktivitete që i japin dashuri dhe zell për të lexuarit;
- të diskutojë parapëlqimet dhe interesat e tij për sa i përket të lexuarit;
- të lexojë për kënaqësi për një kohë të gjatë.

#### **Të shkruarit**

Kurrikula duhet t'i ofrojë nxënësit mundësitë e mëposhtme:

- të zhvillojë pavarësi në të shkruar;
- të bëjë shkrime të gjata për të zhvilluar idetë e tij në detaje;
- të “*luajë*” me gjuhën dhe të eksplorojë mënyra për të zbuluar dhe për të ndërtuar kuptimin;
- të ndërmarrë role dhe këndvështrime të ndryshme;
- të vlerësojë në mënyrë konstruktive shkrimet e tij dhe të tjerëve;
- t'u përgjigjet në mënyrë konstruktive shkrimeve të tij dhe të tjerëve;
- të përdorë njohuritë e tij gjuhësore dhe letrare në shkrime të ndryshme;
- të zhvillojë aftësitë e të shkruarit mbi tema nga fusha të ndryshme të dijes;



- të punojë me pjesë të shkrimtarëve të ndryshëm, për të mësuar sa më tepër mbi artin e të shkruarit;
- të shkruajë për kontekste dhe qëllime reale jashtë klase.

### **Të folurit**

Kurrikula duhet t'i ofrojë nxënësit mundësitë e mëposhtme:

- të përdorë një seri teknikash prezantimi;
- të përfshihet në aktivitete të shumëllojshme ku i kërkohet të flasë;
- të përdorë aftësitë e të folurit për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit dhe të të shkruarit;
- të vlerësojë, duke u përgjigjur në mënyrë konstruktive, prezantimet e tij dhe të të tjerëve;
- të japë kontributin e tij në prezantime të ndryshme gojore (individuale ose në grup);
- të zhvillojë aftësitë e të folurit mbi tema nga fusha të ndryshme të dijes;
- të marrë pjesë në realizime skenike;
- të diskutojë me aktorë, drejtues, e profesionistë mbi mënyrat sesi prezantimet e ndryshme ndikojnë mbi audiencën;
- të flasë për audiencë dhe qëllime reale jashtë klase.

### **Të dëgjuarit**

Kurrikula duhet t'i ofrojë nxënësit mundësitë e mëposhtme:

- të përdorë një seri teknikash dëgjimi;
- të përfshihet në aktivitete të shumëllojshme ku i kërkohet të dëgjojë;
- të përdorë aftësi të të dëgjuarit për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit dhe të të shkruarit;
- të zhvillojë aftësitë e të dëgjuarit mbi tema nga fusha të ndryshme të dijes;
- të dëgjojë në kontekste reale jashtë klase.

## Të vështruarit

Kurrikula duhet t'i ofrojë nxënësit mundësitë e mëposhtme:

- të përdorë një seri teknikash vështrimi;
- të përfshihet në aktivitete të shumëllojshme ku i kërkohet të vështrojë;
- të përdorë aftësi të të vështruarit për të përmirësuar aftësitë e të lexuarit dhe të të shkruarit;
- të zhvillojë aftësitë e të vështruarit të dokumenteve mbi tema nga fusha të ndryshme të dijes;
- të vështrojë në kontekste reale jashtë klase.

## 1.4 OBJEKTIVA TË ARRITJES

### KLASA E 10<sup>te</sup>

Objektiva të arritjes të kurrikulës bërthamë për **të shkruarit**, në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për klasën e 10<sup>te</sup>.

<p><b>Njohja dhe të kuptuarit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përcaktojë temën për të cilën shkruan.</li> <li>- të përdorë strategji të larmishme (brainstorm-i, shkrimi i lirë, kllasteri, diagrami i Venit etj.) për të planifikuar shkrimin e tij/saj;</li> <li>- të shkruajë pjesë komplekse me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;</li> <li>- të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, organizimi, përmbajtja, drejtshkrimi, pikësimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij/ e saj dhe të të tjerëve;</li> <li>- të përdorë në shkrimet e veta karakteristikat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;</li> </ul>
---------------------------------------	---

<p><b>Zbatimi dhe analiza</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përvijojë (skicojë/hartojë) një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor;</li> <li>- të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente;</li> <li>- të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore;</li> <li>- të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara;</li> <li>- të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, përkufizime dhe shembuj;</li> <li>- të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm;</li> <li>- të përdorë stil vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës;</li> <li>- të përdorë stil vetjak për kënaqësi estetike;</li> <li>- të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit;</li> <li>- të përdorë rrallë, por në mënyrë efektive, klishetë dhe zhargonet;</li> <li>- të përdorë struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat ndihmojnë lexuesin përgjatë leximit;</li> <li>- të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse;</li> <li>- të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj;</li> <li>- të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj;</li> <li>- të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve;</li> </ul>
---	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore të tilla, si: fjalor, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim;</li> <li>- të zbatojë ligjin “Për të drejtën e autorit/autore” ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim;</li> <li>- të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën në shkrimin e tij;</li> <li>- të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të shkruarit (parashkrimi, skicimi/hartimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi) duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë;</li> <li>- të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të tjerëve;</li> <li>- të shkruajë tekste përshkruese për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë tekste shpjeguese për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë tekste bindëse /argumentuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë tekste informative (aplikime për shkollë, letër zyrtare) për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë parafrazime të teksteve për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë përmbledhje të teksteve të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë përmbledhje analitike të teksteve të ndryshme;</li> <li>- të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat:</li> </ul>
--	--

	<p>a) zhvillojnë një ide;</p> <p>b) kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin;</p> <p>c) përfshijnë informacione të rëndësishme duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme;</p> <p>d) bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike;</p> <p>e) mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura;</p> <p>f) paraqesin përfundimi koherente.</p>
<p><b>Sinteza dhe vlerësimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin këndvështrimin, organizimin, koherencën (rrjedhën logjike) dhe qartësinë e mendimit;</li> <li>- të përdorë mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar;</li> <li>- të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive të tilla, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj;</li> <li>- të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën elemente të tilla, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi.</li> </ul>

Objektiva të arritjes të kurrikulës bërthamë për **të folurit**, në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për klasën e 11<sup>të</sup>.

<p><b>Njohja dhe të kuptuarit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëjë pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme;</li> <li>- të zgjedhë tekste letrare për të trajtuar tema të ndryshme;</li> <li>- të zgjedhë fjalët e duhura për të ruajtur tonin e përshtatshëm në diskutime e prezantime me gojë;</li> <li>- të zgjedhë fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e prezantime me gojë.</li> </ul>
<p><b>Zbatimi dhe analiza</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të luajë role të ndryshme në një diskutim: rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit;</li> <li>- të paraqesë alternativën personale mbi çështjen a tekstin e caktuar;</li> <li>- të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audienca, situata dhe kontekste të caktuara;</li> <li>- të respektojë kërkesën për një përmbajtje të ngjeshur duke marrë parasysh faktorin kohë;</li> <li>- të parashtrijë argumentin qartë, me përpikëri, përmes një përmbajtjeje të ngjeshur, e me gjuhë të pasur duke respektuar faktorin kohë;</li> <li>- të analizojë përfundimet e një diskutimi;</li> <li>- të shprehë një mesazh koherent;</li> <li>- të marrë parasysh rolin e audiencës, të qëllimit, rastit dhe të një kohe të caktuar në një diskutim;</li> <li>- të shfrytëzojë pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij/saj në diskutime në grupe të vogla e të mëdha;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të diskutojë tekste letrare për të zbuluar tema të ndryshme;</li> <li>- t'u përgjigjet pyetjeve të audiencës duke dhënë sqarime, ilustrime dhe plotësime;</li> <li>- të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutime të llojeve të ndryshme për të ndarë me të tjerët mendimet e tij/saj;</li> <li>- të parafranojë komente të paraqitura me gojë nga të tjerët, për të sqaruar këndvështrimin e tyre;</li> <li>- të zbatojë udhëzime të ndryshme me gojë, për të kryer detyra specifike, për t'u përgjigjur pyetjeve ose për të zgjidhur probleme;</li> <li>- të analizojë në mënyrë kritike qëndrimin ose këndvështrimin e autorit;</li> <li>- të identifikojë elemente verbale dhe joverbale në komunikimin gojor;</li> <li>- të marrë parasysh faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta, këndvështrimi etj.) që ndikojnë në ndërtimin e mesazhit të tij/saj;</li> <li>- të analizojë punën në grup;</li> <li>- të përdorë elemente të gjuhës së gjesteve, të domosdoshme për të paraqitur mesazhin;</li> <li>- të shpjegojë praninë dhe rolin e dialekteve: toskërisht, gegnisht dhe arbërisht, në një tekst letrar;</li> <li>- të marrë parasysh rolin e vlerësimit në komunikimin gojor;</li> <li>- të përdorë mjete retorike për të shprehur idetë, në diskutime dhe prezantime me gojë;</li> </ul>
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të paraqesë në mënyrë individuale një çështje/temë, që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara;</li> <li>- të paraqesë në grup një çështje/temë të caktuar, që lidhet me konceptet dhe temat e trajtuara në tekstet e lexuara;</li> <li>- të përdorë një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagramë, grafikë, kllaster);</li> <li>- të demonstrojë strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm);</li> <li>- të respektojë faktorin kohë në prezantimet me gojë;</li> </ul>
<p><b>Sinteza dhe vlerësimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të mbajë një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup;</li> <li>- të kundërshtojë një pozicion në diskutimet që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha;</li> <li>- të shprehë mendimin kritik për nevojën e dialektalizmave, fjalëve të moçme, për karakterizimin e kohës dhe të karaktereve;</li> <li>- të përpunojë prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën;</li> <li>- të redaktojë, në mënyrë të pavarur, projektpropozime të fjalimeve;</li> <li>- të analizojë prezantimin e tij për ta përmirësuar atë.</li> </ul>



Objektiva të arritjes të kurrikulës bërthamë për **të vështruarit**, në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për klasën e 12<sup>te</sup>.

<p><b>Njohja dhe të kuptuarit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zgjedhë format mediatike të përshtatshme për qëllimin e lexuesit;</li> <li>- të identifikojë stereotipe gjinore, etnike etj. në media të ndryshme;</li> <li>- të identifikojë format, teknikat dhe teknologjitë e përdorura në mesazhe dhe paraqitje të ndryshme mediatike.</li> </ul>
<p><b>Zbatimi dhe analiza</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet mesazheve pamore e të shtypura;</li> <li>- të shpjegojë mënyrën sesi fjalët, tingujt dhe imazhet përcjellin një mesazh;</li> <li>- të analizojë aspekte të tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit;</li> <li>- të shpjegojë se mesazhet mediatike përcjellin përfaqësime të realiteteve sociale dhe kulturore që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme;</li> <li>- të analizojë aspekte të tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit;</li> <li>- të shpjegojë përdorimin e fjalëve, tingujve e imazheve statike dhe të lëvizshme, në mesazhe të ndryshme mediatike, për qëllime të ndryshme;</li> <li>- të zbulojë anë të përbashkëta dhe dalluese për mënyrën si forma të ndryshme mediatike (gazeta, radioja, televizioni, interneti etj.) shtjellojnë tema të njëjta;</li> <li>- të analizojë media të ndryshme për stereotipe gjinore, etnike etj.;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë teknikat pamore (ngjyra, zmadhim/zvogëlimi, këndvështrimi, përzgjedhja e detajeve) në mesazhe të ndryshme mediatike, të përdorura për një audiencë të caktuar;</li> <li>- të zbulojë të përbashkëta dhe të veçanta të tri ose më shumë burimeve mediatike që ndikojnë tek mesazhi;</li> <li>- të gjejë elemente që ndikojnë te mesazhi në një burim mediatik;</li> <li>- të analizojë përparësitë dhe mangësitë e reklamimit pamor dhe gojor;</li> <li>- të krijojë rubrika vlerësimi për të gjykuar efektivitetin e mesazheve gojore dhe pamore;</li> <li>- të zbulojë kuptimet që fshihen pas imazheve mediatike;</li> <li>- të gjejë veçori të përbashkëta dhe dalluese midis formave të ndryshme mediatike, p.sh.: filmi dhe versioni i tij në libër;</li> <li>- të përdorë tekste të medieeve të shtypura dhe elektronike për të zbuluar marrëdhëniet njerëzore, idetë dhe aspektet kulturore;</li> <li>- të diskutojë për ndikimet politike e kulturore, ekonomike e sociale në media të ndryshme;</li> <li>- të analizojë përmbajtjen e mesazheve mediatike në lidhje me efektin emocional që ka tek vështruesi;</li> <li>- të krijojë prezantime mediatike dhe raporte të shkruara që përdorin burime multimediatike me imazhe, grafikë, muzikë, efekte tingujsh, të cilat paraqesin një këndvështrim të veçantë mbi çështjen.</li> </ul>
--	---

<p><b>Sinteza dhe vlerësimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të vlerësojë si një produkt mediatik shpreh vlerën e kulturës që e prodhon;</li> <li>- të vlerësojë se mesazhet mediatike janë përfaqësime të realiteteve sociale dhe kulturore që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme;</li> <li>- të vlerësojë efektivitetin e teknikave pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar;</li> <li>- të vlerësojë besueshmërinë e përmbajtjes së mesazheve të ndryshme mediatike;</li> <li>- të vlerësojë forma të ndryshme mediatike, si p.sh.: televizionin, videon, lojërat, muzikën dhe filmin për të kuptuar përshtatshmërinë e mesazhit me audiencën, qëllimin e kontekstin;</li> <li>- të vlerësojë shpejtësinë, besueshmërinë dhe tipare të tjera multimediale në përthithjen e mesazhit mediatik.</li> </ul>
-------------------------------------	--

## 1.5 OBJEKTIVA SPECIFIKË<sup>1</sup> TË ARRITJES TË TË SHKRUARIT NË KURRIKULËN BËRTHAMË TË GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË, KLASA E 10-TË

*Të përcaktojë temën për të cilën shkruan.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të tregojë njohuri për konceptin e temës në tekste të ndryshme.
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë temën në tekste të ndryshme.
<b>I lartë</b>	- të përcaktojë temën për të cilën shkruan.

<sup>1</sup> Në klasën e dhjetë janë dhënë objektivat specifike të të shkruarit. Për vitet e tjera janë dhënë vetëm disa modele, pasi mendohet se tashmë mësuesit e kanë më të thjeshtë për t'i hartuar ato sipas niveleve.

*Të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit (parashkrimi, draftimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi) duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të tregojë se e njeh konceptin e parashkrimit, skicimit, rishikimit, shkrimit dhe dorëzimit;</li> <li>- të tregojë elementet e parashkrimit, skicimit, rishikimit dhe shkrimit.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë kriteret për realizimin e parashkrimit, skicimit, rishikimit dhe shkrimit.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit (parashkrimi, skicimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi) duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë.</li> </ul>

*Të përdorë strategji të larmishme (brainstormi, shkrimi i lirë, diagrami i Venit) për të planifikuar shkrimin e tij/saj.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë strategji që e ndihmojnë në planifikimin e një shkrimi (brainstormi, shkrimi i lirë, diagrama e Venit).</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shpjegojë strukturën e strategjisë së brainstorm-i, shkrimit të lirë, kllasterit, diagramës së Venit, që e ndihmojnë në planifikimin e një shkrimi.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë strategji të larmishme (brainstormi, shkrimi i lirë, diagrami i Venit etj.) për të planifikuar shkrimin e tij/saj.</li> </ul>

*Të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, organizimi, përmbajtja, drejtshkrimi, pikësimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij/ e saj dhe të të tjerëve.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e sistemit të vlerësimit;</li> <li>- të tregoj cilat janë elementet e një sistemi vlerësimi.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shpjegojë rolin e çdo elementi të sistemit të vlerësimit.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë elementet e sistemit të vlerësimit (ideja kryesore, organizimi, përmbajtja, drejtshkrimi, pikësimi, fjalori, saktësia gramatikore, referencat) për shkrimin e tij/ e saj dhe të të tjerëve.</li> </ul>

*Të përdorë në shkrimet e veta karakteristikat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e tonit në një tekst.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë tonin e përdorur në tekste të ndryshme;</li> <li>- të zbulojë karakteristika të teksteve të ndryshme;</li> <li>- të identifikojë veçori të gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë në shkrimet e veta karakteristikat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme.</li> </ul>

*Të draftojë (skicojë/hartojë) një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e idesë kryesore në një tekst të dhënë;</li> <li>- të njohë konceptin e nënideve në një tekst të dhënë;</li> <li>- të njohë konceptin e organizimit të një teksti të dhënë.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë idenë kryesore në një tekst të dhënë;</li> <li>- të zbulojë nënidetë në një tekst të dhënë;</li> <li>- të tregojë organizimin e një teksti të dhënë.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të skicojë/hartojë një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor.</li> </ul>

*Të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e hyrjes në një tekst;</li> <li>- të njohë konceptin e mbylljes në një tekst;</li> <li>- të tregojë veçori të hyrjes së teksteve të ndryshme;</li> <li>- të tregojë veçori të nbylljes së teksteve të ndryshme.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përzgjedhë hyrje të përshtatshme nga tekste të ndryshme;</li> <li>- të përzgjedhë mbyllje tërheqëse dhe koherente nga tekste të ndryshme.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente.</li> </ul>

*Të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të modelojë lloje të ndryshëm grafikësh, të mësuar në lëndën e matematikës.
<b>I mesëm</b>	- të përcaktojë grafikët që janë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore të shkrimit të tij/e saj.
<b>I lartë</b>	- të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore.

*Të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të përkufizojë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.
<b>I mesëm</b>	- të dallojë fjali të thjeshta dhe të përbëra të llojeve të ndryshme.
<b>I lartë</b>	- të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara.

*Të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e detajit specifik, përshkrimin, përkufizimin dhe shembullit të përdorur në një tekst të dhënë; - të tregojë kriteret e domosdoshme të një gjuhe të saktë.

<b>I mesëm</b>	- të tregojë rolin e gjuhës së saktë, detajit specifik, përshkrimit, përkufizimit dhe shembullit në tekste të ndryshme.
<b>I lartë</b>	- të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, shembuj.

*Të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e audiencës (e lexuesit); - të njohë kriteret për realizimin e një shkrimi bindës.
<b>I mesëm</b>	- të dallojë sesi shkrimtarë të ndryshëm marrin parasysh rolin e lexuesit në shkrimet e tyre.
<b>I lartë</b>	- të shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm.

*Të përdorë stil vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e stilit në shkrimin e një teksti; - të tregojë elemente përbërëse të stilit të shkruarit.
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë stilin e përdorur nga autorë të ndryshëm, në tekste të ndryshme, për të tërhequr vëmendjen e audiencës; - të krijojë stilin vetjak në të shkruar, duke shfrytëzuar njohuritë e marra dhe modele të ndryshme.



<b>I lartë</b>	- të përdorë stil vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës.
----------------	---

*Të përdorë stil vetjak për kënaqësi estetike.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e të shkruarit për kënaqësi estetike (të shkruarit letrar).
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë stilin e autorëve të ndryshëm, të përdorur në tekste të ndryshme; - të tregojë veçori të teksteve të shkruara për kënaqësi estetike.
<b>I lartë</b>	- të përdorë stil vetjak për kënaqësi estetike.

*Të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të dallojë pjesët e ligjëratës, si: mbiemri, emri, ndajfolja etj. të cilat krijojnë imazhe të gjalla në tekste të ndryshme.
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë sesi përdorimi i pjesëve të ndryshme të ligjëratës nga autorë të ndryshëm, në tekste të ndryshme, krijon imazhe të gjalla për lexuesin.
<b>I lartë</b>	- të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit.

*Të përdorë rrallë, por në mënyre efektive, klishetë dhe zhargonet.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e zhargonit dhe të klishesë;</li> <li>- të tregojë veçoritë e klishesë dhe zhargonit.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të identifikojë rastet kur autorë të ndryshëm kanë përdorur klishe dhe zhargone;</li> <li>- të tregojë rolin e përdorimit të <i>klisheve dhe zhargoni</i> në tekste të ndryshme.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë rrallë, por në mënyre efektive, klishetë dhe zhargonet.</li> </ul>

*Të përdorë struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat ndihmojnë lexuesin përgjatë shkrimit.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e kronologjisë, sekuencës, titullit, nëntitullit;</li> <li>- të gjejë titullin, nëntitullin në tekste të ndryshme;</li> <li>- të tregojë kronologjinë e ngjarjeve, fakteve dhe sekuencat në tekste të ndryshme.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shpjegojë rolin e përdorimit të kronologjisë dhe sekuencave në tekste të ndryshme.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë struktura, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat ndihmojnë lexuesin përgjatë shkrimit.</li> </ul>

*Të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur fjalitë dhe paragrafët.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të gjejë lidhëzat dhe fjalët lidhëse (lidhëzat e periudhave dhe lidhëzat e tekstit) në tekste të ndryshme.
<b>I mesëm</b>	- të përcaktojë llojin e lidhëzave dhe fjalëve lidhëse në tekste të ndryshme.
<b>I lartë</b>	- të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur fjalitë dhe paragrafët.

*Të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/e saj.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë (thotë) rregulla të ndryshme drejtshkrimore.
<b>I mesëm</b>	- të identifikojë raste të përdorimit të shmangieve të gjuhës standarde; - të qortojë përdorimet e gabuara, duke bërë argumentimin e tyre.
<b>I lartë</b>	- të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/e saj.

*Të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të thotë (njohë) rregulla të shenjave të pikësimit, të përdorura brenda fjalisë dhe në fund të fjalisë.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të identifikojë raste të përdorimit të gabuar të shenjave të pikësimit, brenda dhe në fund të fjalisë;</li> <li>- të qortojë përdorimet e gabuara të shenjave të pikësimit, duke bërë argumentimin e tyre.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj.</li> </ul>

*Të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të tjerëve.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë procesin e redaktimit të tekstit;</li> <li>- të thotë rregulla të pikësimit, të përdorura në gjuhën standarde shqipe.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin e të tjerëve;</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë njohuri të pikësimit të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të tjerëve;</li> </ul>

*Të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore të tilla, si: fjalor, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë procesin e qortimit të punëve më shkrim;</li> <li>- të njohë fjalorë të ndryshëm, libra gjuhësorë që e ndihmojnë për të qortuar punët me shkrim.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë procesin e përdorimit të fjalorëve të ndryshëm, të librave gjuhësorë dhe internetit, të cilët e ndihmojnë në qortimin e punëve me shkrim.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore, si: fjalorë, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim.</li> </ul>

*Të zbatojë ligjin “Për të drejtën e autorit” ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë ligjin “për të drejtat e autorit”.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë në tekste të ndryshme si është zbatuar ligji “Për të drejtat e autorit”;</li> <li>- të gjejë raste të mosrespektimit të ligjit “Për të drejtat e autorit”, duke shprehur qëndrimin e tij/ e saj ndaj këtyre shkeljeve.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë ligjin “Për të drejtën e autorit” ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim.</li> </ul>

*Të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën në shkrimin e tij.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e qëllimit të një shkrimi;</li> <li>- të njohë rolin e audiencës në një shkrim.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë qëllimin e një shkrimi;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e një shkrimi;</li> <li>- të tregojë rolin që ka përfshirja e audiencës në një shkrim për ta bërë atë të efektshëm;</li> <li>- të përcaktojë qëllimin e shkrimit të tij/ e saj;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e shkrimit të tij/ e saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën në shkrimin e tij/saj.</li> </ul>

*Të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit (parashkrimi, skicimi, shkrimi, rishikimi, dorëzimi) duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e parashkrimit, skicimit, shkrimit, rishikimit, dhe dorëzimit të një shkrimi;</li> <li>- të demonstrojë se njeh veçoritë e parashkrimit, skicimit, shkrimit, rishikimit, dhe dorëzimit të një shkrimi.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë elementet e parashkrimit, skicimit, shkrimit, rishikimit, dhe dorëzimit të një shkrimi.</li> </ul>

<b>I lartë</b>	- të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të shkruarit (parashkrimi, skicimi, shkrimi, rishikimi, dorëzimi) duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë.
----------------	---

*Të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të tjerëve.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e redaktimit.
<b>I mesëm</b>	- të identifikojë veçori të gjuhës standarde (sintaksë, morfologji, drejtshkrim, pikësim etj.), të përdorura në tekste të ndryshme.
<b>I lartë</b>	- të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të tjerëve.

*Të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin, këndvështrimin, organizimin, koherencën (rrjedhën logjike) dhe qartësinë e mendimit.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e stilit, koherencës (rrjedhës logjike), këndvështrimit, qartësisë së mendimit.

<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të respektojë rrjedhën logjike të ngjarjeve, veprimeve etj., në shkrimet e tij/ e saj;</li> <li>- të përdorë një organizim strukturor të përshtatshëm për çështjen që trajton në shkrimet e tij/ e saj;</li> <li>- të trajtojë çështje nga këndvështrime të ndryshme;</li> <li>- të shprehë qartë mendimet e tij/ e saj;</li> <li>- të vlerësojë redaktimin si një hap të rëndësishëm të një produkti gjuhësor;</li> <li>- të përdorë stil vetjak në shkrimet e tij/ e saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin këndvështrimin, organizimin, koherencën (rrjedhën logjike) dhe qartësinë e mendimit.</li> </ul>

*Të përdorë mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë procesin e redaktimit në një shkrim.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të marrë parasysh mendimet e të tjerëve që e ndihmojnë për të përmirësuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar.</li> </ul>



*Të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë faktorin lexues në shkrimin e një teksti.
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë interesat e lexuesve të ndryshëm, për t'i trajtuar në shkrimet e tij / e saj, duke përdorur gjuhë të përshtatshme, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj.
<b>I lartë</b>	- të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj.

*Të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën elemente, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e stilit, mjeteve letrare, përzgjedhjes së fjalëve, tonit, përmbajtjes dhe këndvështrimit.
<b>I mesëm</b>	- të zbulojë, në tekste të ndryshme, elemente, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi; - të shpjegojë rolin e stilit, mjeteve letrare, përzgjedhjes së fjalëve, tonit, përmbajtjes e këndvështrimit, të përdorura në tekste të ndryshme; - të shpjegojë si ndikojnë mbi audiencën elemente, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi.

<b>I lartë</b>	- të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën elemente, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi.
----------------	---

*Të shkruajë tekste përshkuese për qëllime dhe audiencë të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë tekste përshkuese, të shkruara për qëllime dhe audiencë të ndryshme;</li> <li>- të tregojë audiencën që i drejtohet një shkrim përshkues;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një shkrimi përshkues.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të teksteve përshkuese;</li> <li>- të përdorë elemente të përshkrimit të shkrimi i tij/ i saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	- të shkruajë tekste përshkuese për qëllime dhe audiencë të ndryshme.

*Të shkruajë tekste shpjeguese për qëllime dhe audiencë të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë tekste shpjeguese, të shkruara për qëllime dhe audiencë të ndryshme;</li> <li>- të tregojë audiencën së cilës i drejtohet një shkrim shpjegues;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një shkrimi shpjegues.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të teksteve shpjeguese;</li> <li>- të përdorë elemente të shpjegimit të shkrimit i tij/ e saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	- të shkruajë tekste shpjeguese për qëllime dhe audiencë të ndryshme.

*Të shkruajë tekste bindëse /argumentuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë tekste bindëse/argumentuese, të shkruara për qëllime dhe audiencia të ndryshme;</li> <li>- të tregojë audiencën së cilës i drejtohet një shkrim bindës/argumentues;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një shkrimi bindës/argumentues.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të teksteve bindëse/argumentuese;</li> <li>- të përdorë elemente të argumentimit dhe bindjes në shkrimin e tij/ e saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë tekste bindëse /argumentuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme.</li> </ul>

*Të shkruajë tekste informative (aplikime për shkollë, letër zyrtare) për qëllime dhe audiencia të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë tekste informative, të shkruara për qëllime dhe audiencia të ndryshme,</li> <li>- të tregojë audiencën së cilës i drejtohet një shkrim informativ,</li> <li>- të tregojë qëllimin e një shkrimi informativ.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të teksteve informative;</li> <li>- të përdorë elemente të informimit në shkrimin e tij/ e saj.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë tekste informative (aplikime për shkollë, letër zyrtare) për qëllime dhe audiencia të ndryshme.</li> </ul>

*Të shkruajë parafrazime të teksteve për qëllime dhe audiencë të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	Objektivi specifik
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e parafrazimit të tekstit.
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë veçori të parafrazimit të tekstit;</li> <li>- të përdorë teknika të parafrazimit;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e një parafrazimi;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një parafrazimi;</li> <li>- të respektojë elementet e një parafrazimi;</li> <li>- të përdorë teknika të parafrazimit.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	- të shkruajë parafrazime të teksteve për qëllime dhe audiencë të ndryshme.

*Të shkruajë përmbledhje të teksteve të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	Objektivi specifik
<b>Bazë</b>	- të njohë konceptin e përmbledhjes së tekstit.
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë veçori të përmbledhjes së tekstit;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e një përmbledhjeje;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një përmbledhjeje;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e një përmbledhjeje;</li> <li>- të respektojë elemente të përmbledhjes;</li> <li>- të përdorë teknika të përmbledhjes.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	- të shkruajë përmbledhje të teksteve të ndryshme.

*Të ndërtojë me shkrim harta të teksteve të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	Objektivi specifik
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e hartës së tekstit;</li> <li>- të njohë strukturën e hartës së tekstit.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë elementet strukturor në ndërtimin e hartës së tekstit.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të ndërtojë me shkrim harta të teksteve të ndryshme.</li> </ul>

*Të shkruajë përmbledhje analitike të teksteve të ndryshme.*

<b>Niveli</b>	Objektivi specifik
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e përmbledhjes analitike të tekstit.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë veçori të përmbledhjes analitike;</li> <li>- të përdorë teknika të përmbledhjes analitike;</li> <li>- të përcaktojë audiencën e një përmbledhjeje analitike;</li> <li>- të tregojë qëllimin e një përmbledhjeje analitike;</li> <li>- të respektojë elemente të përmbledhjes analitike.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë përmbledhje analitike të teksteve të ndryshme.</li> </ul>

*Të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat:*

- a. zhvillojnë një ide;
- b. kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin;
- c. përfshijnë informacione të rëndësishme duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme;
- d. bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike;
- e. mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e

thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura;

f. paraqesin përfundime koherente.

Niveli	Objektivi specific
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë konceptin e idesë, organizimit strukturor, qëllimit, audiencës, kontekstit, informacionit të rëndësishëm dhe jo të rëndësishëm në tekste të ndryshme;</li> <li>- të dallojë përfundimet koherente të teksteve të ndryshme.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë elemente të organizimit strukturor në shkrimet e tij/ e saj;</li> <li>- të respektojë qëllimin, audiencën dhe kontekstin për të cilin shkruan;</li> <li>- të përfshijë informacione të rëndësishme në shkrimet e tij/ e saj;</li> <li>- të mbështesë gjykimin e ti/ e saj me të dhëna të përshtatshme dhe me detaje të përzgjedhura;</li> <li>- të shkruajë përfundime koherente.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë lloje të ndryshme tekstesh, të cilat:               <ol style="list-style-type: none"> <li>a. zhvillojnë një ide;</li> <li>b. kanë një organizim strukturor të përshtatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin;</li> <li>c. përfshijnë informacione të rëndësishme duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme;</li> <li>d. bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike;</li> <li>e. mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura;</li> <li>f. paraqesin përfundimi koherente.</li> </ol> </li> </ul>

**Klasa e 11-të**

- *Të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audiencë, situata dhe kontekste të caktuara.*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të demonstron njohuri për konceptin e përmbajtjes së ngjeshur të audiencës dhe situatës në kontekste të caktuara.
<b>I mesëm</b>	- të gjejë këto në tekste të ndryshme verbale.
<b>I lartë</b>	- të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audiencë, situata dhe kontekste të caktuara.

- *të përdorë mjete retorike për të shprehur idetë, në diskutime dhe prezantime me gojë;*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të tregojë njohuri të ndryshme për mjetet retorike.
<b>I mesëm</b>	- të gjejë mjetet retorike të përdorura në tekste të ndryshme verbale.
<b>I lartë</b>	- të përdorë mjete retorike për të shprehur idetë, në diskutime dhe paraqitje me gojë;

- *të përpunojë prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën;*

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	- të tregojë njohuri për kriteret e ndërtimit të një paraqitjeje gojore.
<b>I mesëm</b>	- të ndërtojë një paraqitje gojore.
<b>I lartë</b>	- të përpunojë paraqitjen gojore për të orientuar drejt audiencën.
<b>I lartë</b>	- të skicojë një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor.

**Klasa e 12-të**

- të zbulojë veçori të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet mesazheve pamore e të shtypura;

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të tregojë njohuri për ndërtimin e mesazheve pamore;</li> <li>- të tregojë njohuri për ndërtimin e mesazheve të shtypura.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojë veçori të mesazheve pamore;</li> <li>- të dallojë veçori të mesazheve të shtypura;</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbulojë veçori të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet mesazheve pamore e të shtypura.</li> </ul>

- të përdorë tekste të mediave të shtypura dhe elektronike për të zbuluar marrëdhëniet njerëzore, idetë dhe aspektet kulturore;

-

<b>Niveli</b>	<b>Objektivi specifik</b>
<b>Bazë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të tregojë njohuri për marrëdhëniet e ndryshme shoqërore, idetë dhe aspektet kulturore.</li> </ul>
<b>I mesëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të identifikojë marrëdhënie shoqërore, ide dhe aspekte kulturore në tekste të mediave të ndryshme.</li> </ul>
<b>I lartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë tekste të mediave të shtypura dhe elektronike për të zbuluar marrëdhënie njerëzore, ide dhe aspekte kulturore.</li> </ul>



## 2. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Kjo pjesë përbëhet nga:

*A. disa strategji dhe teknika për të lexuarit e qëllimshëm*

*B. metodologji për zhvillimin e të kuptuarit dhe të të lexuarit*

*C. modele të orëve mësimore*

### A. Strategji për të lexuarit e qëllimshëm

Për realizimin e objektivave të programit është e domosdoshme të njihen dhe të zbatohen teknika dhe strategji të ndryshme, të cilat ndihmojnë në të kuptuarit dhe të ndërtuarit e teksteve të llojeve të ndryshme. Më poshtë po japim disa teknika dhe strategji, të cilat ndihmojnë jo vetëm në përmbushjen e objektivave, por mundësojnë realizimin e një procesi mësimor që ka në qendër nxënësin.

Pasi lexojmë një tekst, ajo çka duam të arrijmë është të kuptojmë përmajtjen e tij. Procesi i të kuptuarit është i lidhur ngushtë me shkallën e zhvillimit të aftësive për të kuptuar, që arrihet duke zbatuar disa teknika dhe strategji të domosdoshme për këtë proces.

Cilat janë disa nga strategjitë e të lexuarit të qëllimshëm?

- **Harta e tregimit**

Kur lexojmë një tregim shpesh kërkojmë të përqendrohemi në elemente, si: personazhet, koha dhe vendi ku ndodh ngjarja, subjekti (fabula e tregimit), tema. Këto elemente janë të domosdoshme, sepse e ndihmojnë lexuesin në procesin e të kuptuarit.

Si realizohet harta e tregimit?

Pasi lexohet teksti, vëmendja përqendrohet te:

1. *Personazhet/karakteret*: Cilët janë njerëzit e përfshirë në ngjarje?

Kush luan rolin kryesor dhe kush role të dyta?

2. *Koha*: Kur zhvillohen ngjarjet? (është e rëndësishme të specifikohet koha me detaje të tjera domethënëse)

3. *Vendi i ngjarjes*: Ku zhvillohen ngjarjet? (duhet të përcaktohet jo vetëm vendi si njësi gjeografike, por të jepen edhe elemente (detaje) që ndihmojnë në trajtimin e fabulës së tregimit)

4. *Subjekti* (fabula e tregimit) i përbërë nga tri pjesë:

a) *Problemi/synimi*: Çfarë ngjarjesh zhvillohen? Ç'probleme ngrihen? Çfarë sunojnë?

b) *Episodet*: Hapat kyç ose ngjarjet që ndihmojnë (nxisin) zhvillimin e situatës.

c) *Zgjidhja*: Çfarë rezultoi? Si ishte zgjidhja?

Kush e zgjidhi problemin? A u realizuan synimet?

5. *Tema*: a. Pse është e rëndësishme kjo ngjarje deri në ditët tona?

b. Ku qëndron rëndësia e saj?

c. Çfarë mësojmë prej saj?

Tema mund të përcaktohet:

- si e vërtetë universale,

- si e vërtetë personale.

- **Diagrami i Venit**

Çfarë është diagrami i Venit?

Është prezantimi i veçorive të përbashkëta dhe të ndryshme ndërmjet koncepteve, personazheve, ngjarjeve etj. Është një strategji e ndërtuar nga ndërprerja e rathëve. Në secilin rreth shkruhen karakteristikat e personazheve dhe tek pjesa e ndërprerë vendosen të përbashkëtat mes tyre.


Për çfarë përdoret?

Diagrami i Venit është një organizues i thjeshtë grafik që ndihmon

nxënësit të mendojnë rreth të përbashkëtave dhe dallimeve ndërmjet koncepteve, personazheve, ngjarjeve. Është më mirë që nxënësit ta bëjnë vet krahasimin, sesa t’jua japë të gatshme mësues/i,-ja, pasi ata vazhdimisht në jetën e përditshme krahasojnë gjëra të ndryshme, p.sh.: veshje, filma, artistë, shokë etj. Ajo çfarë duhet të bëjë mësues/i,-ja është që të mbështesë mendimin e tyre për ndryshimet dhe ngjashmëritë e rëndësishme që përcaktojnë.

### Si realizohet?

Theksojmë se vlera e diagramit të Venit është *realizimi* i tij. Kjo kërkon që fillimisht, nxënësit të identifikojnë karakteristikat për çështje a koncepte të caktuara. Kur nxënësit fillojnë të plotësojnë diagramin, mësuesi nuk duhet t’u thotë: *kjo është mirë e kjo gabim*. E mira është që mësuesi t’i lërë vetë nxënësit të gjykojnë për zgjedhjet e tyre duke u kërkuar që të arsyetojnë për to (p.sh.: diagrama e Gjergj Elez Alisë dhe Bajlozi).



*Diagrama e Venit mund të përdoret edhe si diagrama e të përbashkëtave dhe dallimeve, kjo në varësi të asaj që duam të realizojmë.*

### Diagrama e të përbashkëtave dhe dallimeve

Po japim hapat e realizimit të diagramës së të përbashkëtave dhe dallimeve. *Krahaso* veçoritë e gjuhës shqipe që dalin te poezia e Fishtës dhe e Mjedës.

Krahasimet do të bëhen me diagramën e Venit.

Hapi I: Leximi i poezive

Hapi II: Zbulohen karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta të poezive, me anë të diagramit të Venit.

Hapi III: Gjetja e dallimeve dhe e të përbashkëtave sipas pikëvështrimeve të përcaktuara.

“Gjuha shqipe”  
e Mjedës

**Si ngjajnë**  
në lidhje me :

“Gjuha shqipe” e  
Fishtës

1. Temën që trajton

2. Mesazhin që përcjell

3. Gjuhën e përdorur  
etj...

Gjuha shqipe  
Mjeda

**Si ndryshojnë**  
në lidhje me:

Gjuha shqipe  
Fishta

1. Fjalët që karakterizojnë  
gjuhën shqipe

2. Thirrjen që u drejton shqiptarëve

3. Rolin e gjuhës

- **Problemzgjdhja**

Është një strategji që ndihmon nxënësin për të zhvilluar të nxënit aktiv; ajo përqëndrohet në 4 fushat e problemzgjdhjes kritike:

- 1) identifikimi i problemit,
- 2) renditja e pasojave të problemit,
- 3) veçimi i shkaqeve,
- 4) propozimi i zgjidhjeve.

*Si realizohet problemzgjdhja?*

Fillimisht nxënësit identifikojnë problemin, pastaj listojnë pasojat e problemit.

Ata sjellin ndër mend të gjitha shkaqet e lindjes së problemit dhe mendojnë zgjidhjen e tij. Është një strategji e mirë për të zgjidhur bashkarisht çështje, jo vetëm në fushën e përmbajtjes, por edhe në drejtime të tjera.

## **B. Metodologji e përgjithshme për zhvillimin e të kuptuarit dhe të të lexuarit**

Studimi i lëndës së gjuhës shqipe dhe i letërsisë konsiston në zhvillimin e të kuptuarit dhe të të krijuarit të nxënësve.

***Të kuptuarit*** përfshin një gamë të aftësive perceptuese.

Kjo nënkupton aftësinë:

- për të lexuar, për të dëgjuar dhe për të vështruar në mënyrë të përshtatshme;
- për të kuptuar tekste në nivelin fillestar, si dhe atë të kuptimit të mëtejshëm;
- për të interpretuar dhe për të vlerësuar tekste;
- për të kuptuar gjuhën e orientuar në përshtatje me tekste të llojeve të

- ndryshme;
- për të pyetur rreth teksteve; objekti i letërsisë (njeriu dhe bota);
- për të kuptuar karakterin fytyrëzues dhe *trillimin artistik* në tekstet letrare;
- për të zbuluar funksionin estetik të teksteve letrare;
- për të kuptuar aftësitë e mëdha shprehëse të shqipes si gjuhë arti, kulture e më gjerë;
- për të kuptuar se si punojnë tekstet;
- për të identifikuar zhanret, llojet e teksteve.

***Të krijuarit*** përfshin një sërë aftësish shprehëse / komunikative.

Kjo nënkupton aftësinë:

- për të folur, për të shkruar dhe për të ndërtuar tekste në mënyrë të përshtatshme, p.sh.: të studiosh dhe të zbulosh përvoja në disa zhanre, të japësh forma/modele shprehëse dhe me imagjinatë nga këndvështrime personale;
- për të ndërtuar dhe rindërtuar kuptimet e teksteve, në të cilat shprehin ndjesitë dhe përjetimet vetjake;
- për të edukuar shije estetike që nuk pajtohen me mediokren dhe të shëmtuarën në jetë dhe në art;
- për të imituar modele në mënyrë të përshtatshme dhe në mënyrë krijuese;
- për të modeluar/formuar tekste në gjini të ndryshme letrare dhe jo të tilla;
- për të hulumtuar dhe për të përgatitur materialet përkatëse;
- për të zhvilluar një qasje të procesit të kompozimit të teksteve brenda llojeve të ndryshme.

Kjo do të thotë të zhvillosh strategji në fushat e: parashkrimit, shkrimit, rishkrimit, redaktimit dhe korrektimit.

Për zhvillimin e aftësive, nxënësit duhet të ballafaqohen me sa më

shumë materiale që u ngjallin interes dhe u japin një kuptim për botën reale. Rritja e njohurive në përdorimin dhe të kuptuarit e gjuhës arrihen vetëm kur nxënësit e ndiejnë se janë të angazhuar në veprime reale *të të kuptuarit* dhe *të të krijuarit* dhe jo thjesht në imitime apo kopjime mekanike.

Për realizimin e objektivave të programit është e domosdoshme të njihen dhe të zbatohen teknika dhe strategji të ndryshme, të cilat ndihmojnë në *të kuptuarit* dhe *të ndërtuarit* e teksteve të llojeve të ndryshme.

## **I. Qasje dhe metodologji të përgjithshme për zhvillimin e të kuptuarit dhe të të lexuarit**

Rekomandohen këta hapa bazë:

### **Paraleximi**

Për çdo tekst që do të punohet me nxënësit, fillimisht, mësuesi duhet t'i shtrojë vetes dy pyetje:

- A ka interes për nxënësit përmbajtja apo këndvështrimi i këtij teksti?
- Çfarë aftësish të të kuptuarit dhe të të krijuarit mund të mësohen përmes këtij teksti?

### **Leximi**

Gjatë leximit, e rëndësishme është që mësuesi:

1. të specifikojë qartë në planin mësimor, aftësitë e të kuptuarit;
2. t'i tregojë nxënësit sesi të lexojë tekste për një shumëllojshmëri qëllimesh;
3. pasi të punojë me përmbajtjen, duhet ta përqendrojë punën me nxënësit tek procesi i të interpretuarit për zbulimin e domethënies.

*(Nxënësit duhet të jenë njohur me teknika e strategji të ndryshme, të cilat e ndihmojnë për të lexuar në mënyrë të avancuar).*

## **Rileximi**

*Rileximi është arti i të lexuarit.*

Nxënësve duhet t'u jepen disa detyra, të cilat kërkojnë rileximin e tekstit për një shumëllojshmëri qëllimesh. Detyra të tilla:

- dalloni në tekst faktet nga opinionet që jep autori;
- ndërtoni hartën tematike të tekstit;
- luani me kohën dhe hapësirën për të parë se a i qëndrojnë këtij ndryshimi idetë që përcjell teksti etj.;
- interpretoni vërtetësinë e thënies së Romeos: “ Kush s’ka provuar plagët, le të tallet me vragët”.

Qëllimet mund të lidhen me interpretimin, me të dhënat që ka një tekst ose mund të lindin nga kontekste të leximit kritik apo të vetëdijes gjuhësore. E rëndësishme është që nxënësit ta ndiejnë se rileximi ka një qëllim që bëhet.

**Pasleximi**, përgatitja për shkrimin teksteve të zgjedhura ose aspekte të këtyre teksteve mund të përdoren si nxitje dhe modele për nxënësit në punët me shkrim.

Kështu, poezi të ndryshme vazhdojnë në të njëjtën linjë tematike duke respektuar ose jo teknikat poetike të një autori të caktuar. Nxënësit “thirren” në procese krahasimi me tekste të ndërtuara nga i njëjti autor apo autorë të ndryshëm që kanë tematikë dhe këndvështrime të njëjta, p.sh: motërzimet e Ciklit të Kreshnikëve apo 16 rrokshi naimian me atë lasgushian etj. Një model i skicuar qartësisht tregon aspekte karakteristike të përdorimit dhe të strukturës së gjuhës brenda modelit të llojit.

## **Të krijuarit**

Jepini detyrë nxënësve që të angazhohen në procesin e:

- *parashkrimi*: brainstorming, diskutim në grup, hulumtim duke reflektuar mbi atë çka është në modelin e dhënë;
- *skicimitt*: të shkruarit lirisht të ideve duke i zhvilluar në paragrafë;



- *riskicimitt*: përshtatja e përmbajtjes me strukturën, të shkruarit në regjistrin e duhur, përfundimi i paragrafëve dhe përshtatja me formën e të shkruarit;
  - *shkrimit*: rileximi i pjesës së shkruar shërben për të parë qartësinë e mendimit dhe përshtatshmërinë e gjuhës në të gjitha aspektet e tekstit;
  - *korrektimit*: rileximi për të kontrolluar shenjat e pikësimit, drejtshkrimin dhe përdorimet gramatikore.
- Kopja e fundit është një tekst i vërtetë dhe i jep nxënësit ndjenjën e autorësisë.

## Vlerësimi i shkrimit

Nxënësit duhet të qartësohen për kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përcaktuara në bazë të llojit të shkrimit. Kriteret e vlerësimit zbatohen korrektësisht në llojet e shkrimeve informative të tipit, p.sh.: raporte e letra formale dhe ka më shumë liri veprimi në rastin e shkrimit të poezive, tregimeve personale etj.

Zakonisht u jepet rëndësi disa treguesve, të cilët më parë u janë bërë të njohur nxënësve në një tabelë pikëzimi.

## II. Trajtimi i teksteve nga perspektiva të reja

### 1. Teksti dhe gjinitë/zhanret<sup>2</sup>

Konceptet për tekstin dhe gjinitë janë themelore për programin mësimor. Ato mund të përdoren për t'iu referuar çdo produkti komunikativ: me gojë, me shkrim ose vizual. Letra, raporte, artikuj gazetash, fjalime politike, filma, poezi, novela etj., të gjitha mund të përshkruhen si tekste dhe të trajtohen si modele të gjuhës së një gjinie letrare dhe joletrare të

---

Zhanër/gjini janë sinonime.

veçantë ose një kombinim i gjinive. Por kjo nuk do të thotë se të gjitha tekstet janë të barasvlefshme. Një reklamë për çokolatën dhe një sonet shekspirian mund të përshkruhen si tekste, sepse të dyja janë produkte të gjuhës, por ata nuk janë të njëjlojtë për nga vlera kulturore dhe artistike. Të gjitha tekstet janë të krijuara brenda llojeve të caktuara. Një zhanër/gjini mund të përkufizohet si një formë e përdorimit të gjuhës, një formë (model) gjuhësore e krijuar nga një situatë e veçantë e komunikimit.

Çdo situatë komunikimi ndikohet nga faktorë, të cilët ndryshojnë nga veprimet dhe efektet e tyre

I. Këta faktorë janë:

- a) folësi/shkrimtari .....kush?
- b) bashkëfolësi/ audiencë .....kujt?
- c) qëllim i komunikimit .....përse?
- d) marrëdhëniet ndërmjet (X) dhe (Y) ..në çfarë konteksti?

Shembuj për disa lloje tekstesh ku situata e komunikimit ndikohet nga faktorë, të cilët ndryshojnë nga veprimet dhe efektet e tyre.

1. Teksti poetik “Cikli i kreshnikëve”

- a) folësi/shkrimtari /uni lirik .....kush? artisti anonim popull- rapsodi
- b) bashkëfolësi/ audiencë .....kujt? auditorit, të cilit i drejtohet është dhoma malësore e burrave dhe e djemve që preknin pragun e burrërisë.
- c) qëllim i komunikimit .....përse? edukues. Përcjellja brez pas brezi e mesazheve, si: trimëria, dinjiteti, besa, mikpritja etj., jo si informacion, por si vlerë.
- d) marrëdhëniet ndërmjet (X) dhe (Y) ...në çfarë konteksti? në kushtet e një gjendjeje lufte të pandërprerë mes shqiptarëve dhe sllavëve të jugut për të mbrojtur nderin, dinjitetin, kullotat.

2. Teksti dramatik “Romeo dhe Zhuljeta”

- a) shkrimtari ..... kush? Uiljam Shekspir
- b) audienca .....kujt? spektatorit bashkëkohës dhe atij të të gjithë kohërave
- c) qëllim i komunikimit .... përse? përcjellja e idesë se jeta dhe dashuria janë të shtrenjta e nuk duhen humbur.
- d) marrëdhëniet ndërmjet personazheve....në çfarë konteksti? Në kuadër të asaj lëvizjeje të madhe që përfshiu të gjitha fushat e artit dhe dijes njerëzore shek XIV-XVII e që u përshkua nga Humanizmi.

3. Teksti argumentues: “Dje dhe sot”

- a) shkrimtari .....kush? Mitrush Kuteli
- b) audienca .....kujt? gazetarëve, lexuesit shqiptar bashkëkohës
- c) qëllim i komunikimit ..... përse? të kritikonte rolin e shtypit në kulturën shqiptare, duke sjellë si shembull rolin edukues të shtypit shqiptar të kohës së Rilindjes Kombëtare.
- d) marrëdhëniet ndërmjet shtypit dhe publikut ...në çfarë konteksti?  
Jemi në vitet ‘30. Shkak për të trajtuar këtë shqetësim bëhet jeta kulturore “anemike” e Shqipërisë. Shtypi i kohës jo vetëm që nuk transmetonte tek lexuesi vlera të mirëfillta morale, kulturore dhe artistike, por mbushte faqet me antivlera apo metamorfizohej për t’i mbijetuar dhunës së pushtetarëve.

Këta faktorë do të përcaktojnë tiparet/atributet e një teksti:

- *fjalorin dhe regjistrin* (lloji i fjalëve të përdorura);
- *sintaksën* (organizimi i fjalëve brenda fjalive);
- *stilin* (menaxhimi i përgjithshëm i gjuhës);
- *tonin* (qëndrimi dhe pozicioni i shkrimtarit / folësit);

- *srukturën* (organizimi i brendshëm i tekstit);
- *formatin* (paraqitja e jashtme e tekstit).

Konkretisht, shkrimi “*Dje dhe sot*”:

- *fjalori* i orientuar dhe *regjistri* i ngritur;
- *sintaksa*: fjali të plota, larg ndërtimeve eliptike, edhe pse me përdorime stilistike të pyetjeve retorike e të eufemizmave thuajse transparente;
- *stili*: polemizues.;
- *toni*: kritikues dhe këshillues, duke dhënë madje edhe rrugët për të dalë nga gjendja.
- *sruktura* (organizimi i brendshëm i tekstit: **hyrja**, shtrimi i problemit, **teza** ku jepet opinioni i autorit, **bluprinti**, inventari i argumenteve dhe i evidencave që provojnë vërtetësinë e argumenteve, **mbyllja**, *konkluzioni dhe përmbyllja e problemit të shtruar*);
- *formati*: artikull gazete në prozë, i organizuar në paragrafë.

**a.** Atributet gjuhësore të një teksti argumentues do të përcaktohen në varësi të faktit nëse është:

- a) një argument ligjor;
- b) një argument shkencor;
- c) një argument politik;
- d) një argument personal.

**b.** Atributet gjuhësore të një letre përcaktohen në varësi të faktit nëse është:

- a) një letër ngushëllimi;
- b) një letër aplikimi për punë;
- c) një letër për një mik personal.

Secila nga këto letra mund të përshkruhet si një stil i ndryshëm i përcaktuar kryesisht nga konteksti shoqëror.

**Zhanret/gjinitë** janë të rëndësishme në formësimin e komunikimit efektiv në shoqëri, por ato nuk janë të përkryera në elementet e tyre. Gjuha evoluon gjithmonë dhe gjinitë ndryshojnë dhe zhvillohen; gjithashtu brenda një teksti mund të ketë një përzierje të gjinive. Për më tepër shkrimtarët, krijues në një sërë fushash, vazhdimisht përshtatin, ndryshojnë dhe zhvillojnë gjinitë në përpjekjet për të “vizatuar” me fjalë përvojat e tyre. Është e rëndësishme që nxënësit të marrin kompetencat bazë të gjinive komunikuese për të hyrë në shoqëri. Kjo nënkupton një bashkëveprim dialektik të përvojave të nxënësve me strukturat e gjinive dhe të formave të miratuara. Gjinitë janë parë si forma strukturore, të cilat ndihmojnë nxënësit për të organizuar, por nuk përcaktojnë cilësinë ose përmbajtjen e tekstit përfundimtar. **Model aktiviteti Identifikimi i gjinisë së një teksti duke përshkruar edhe cilësitë e tij gjuhësore.** Së pari, lexoni tekstin që keni përzgjedhur. (Po sjellim si shembull një poezi të Dritëro Agollit “Vjen një lumë i turbullt” me nëntitull “Baladë” .

### **Analiza dhe reflektimi**

a. Kjo është një poezi e ndërtuar mbi modele të vargëzimit popullore. Brenda saj jepen tri përjetime të një humbjeje tragjike. Në tri strofa pulsojnë tri drama, me veprime të pritura dhe të papritura. Ajo ka një këndvështrim tejet njerëzor, ton elegjiak, ndërsa në aspektin tingullor përdorimi i zanores “u” 33 herë brenda materialit gjuhësor ndërton/krijon një jehonë dhimbjeje ulëritëse, vajtuese. Mënyra si është shkruar sikur i jep zë dhe fjalë një kabaje jugu **që për nga intensiteti i emocioneve kërkon dhe thërret** një audiencë të veçantë.

Atributet e gjuhës së kësaj gjinie janë të dukshme në të gjithë fragmentin,

p.sh.:

- foljet. . . (*i lutet valës, i përgjunjet valës, i qahet valës*)
- përshkrimi i ekzagjeruar... (*valët mal, me kërcunj përfytur,* )
- fjalë, shprehje dhe zhargon. . . (*valës dhe stërkalës, qan shtëpia tranë, qan oxhaku prushin, çdo natë tërkuzë e gjatë* ).
- dialogu (i shkurtër ose i gjatë): (vetëm uturima iu përgjigjet kur kërkojnë: *nxirrma lumë djalin, as ma nxirr vëllanë, nxirrma burrën* )
- emra . . . (p.sh. : *nëna, motra, nusja* etj.)
- sintaksa dhe struktura e fjalive. (eliptike: *nëna nuk ka tjetër, mbetur trung i vetëm...*, *motra qan vëllanë, qyqja përmbi thanë...*, *nxirrma se jam vetëm, në mos nxirr një tjetër.*)

## Analiza dhe reflektimi

b. Mund të lexoni edhe fragmente të tjera për të identifikuar gjininë e secilit prej tyre. Pyetjet që mund të bëhen në këtë rast janë:

- kush e ka shkruar këtë tekst? Ç’lloj shkrimtari është: poet, novelist, shkencëtar, gazetar, student etj.?
- për cilin është shkruar? (audienca)
- përse është shkruar: për të informuar, për të bindur, për të rrëfyer, për të udhëzuar, për të argëtuar apo për t’i gërshetuar të gjitha këto?
- cilat janë atributet gjuhësore të këtij teksti? Ç’lloj fjalësh, regjistri, sintakse, strukture ka?

Ky lloj reflektimi dhe kjo lloj analize të çojnë në një kuptim më të pasur të asaj që është njohur si *gjuha e vetëdijes*.

## 2. Ndërgjegjësimi gjuhësor

Në përgjithësi përdoruesit e gjuhës amtare i përgjigjen instinktivisht nevojës së të folurit, pa menduar shumë sesi e ndërtojnë kuptimin / domethënien në gjuhën e tyre. Duket se ata i kanë “si të lindura” rregullat

dhe proceset e marrjes së kuptimit të fjalëve. Këto rregulla dhe procese mund të përshkruhen si gramatikë. Të mësuarit e gjuhës shqipe nga shqipfolësit përfshin në mënyrë të pandërgjegjshme gramatikën e gjuhës.

*Të zhvillosh vetëdijen gjuhësore të nxënësit do të thotë ta ndihmosh të bëhet i ndërgjegjshëm për atë që di për gjuhën dhe më pas të bëhet i ndërgjegjshëm për të ndërtuar mbi këtë dijeni. Rritja e ndërgjegjësimit gjuhësor nuk do të thotë vetëm studimi tradicional i gramatikës, i rregullave të sintaksës dhe të pikësimit, i ndërtimit të fjalive, i funksionit të fjalës në fjali etj. **Analiza ka treguar se të mësuarit tradicional nuk është i mjaftueshëm për zhvillimin e rrjedhshmërisë në të shkruar dhe në të folur.***

***Zhvillimi i vetëdijes gjuhësore vjen me studimin dhe të kuptuarit e gjuhës duke e përdorur në kontekste shprehëse të komunikimit real.***

Çfarë duhet të dinë nxënësit për gjuhën?

Ata duhet të dinë:

- Si punon gjuha; si janë përzgjedhur dhe organizuar fjalët në modele, për të krijuar kuptimin/domethënien në një shumëllojshmëri të konteksteve;
- Si është përcaktuar përdorimi i gjuhës kryesisht nga strukturat sociale, vlerat kulturore e politike.
- Si të flasin me një terminologji të përshtatshme, duke zhvilluar atë që quhet **metagjuhë**, pra një gjuhë që flet në lidhje me përdorimin e gjuhës në tekste të ndryshme.

Kjo do të thotë të ndërtosh kuptimin/domethënien me koncepte, si: konteksti, teksti, gjinia, audienca, toni, stili dhe regjistri. Të gjitha këto përshkruajnë situatën në të cilën krijohet teksti, pra strukturat shoqërore dhe kulturore, të cilat veprojnë në formësimin e tekstit. Kjo përbën atë që quhet **makrokoshiencë gjuhësore** ose ndryshe **vetëdija e kontekstit**.

Gjithashtu, nxënësit duhet të kuptojnë dhe të përdorin terma

dhe koncepte, si: shprehje sintaksore, fjali, paragraf, tezë, kohë (e veprimit), pjesë të ligjëratës (emra, folje, mbiemra...), shenjat e pikësimit (shkronja e madhe, pika, presje etj.). Kjo përbën atë që quhet **mikrokoshiencë gjuhësore** ose **vetëdija e tekstit**, që do të thotë të dish dhe të kuptosh sesi këto elemente punojnë për të krijuar kuptimin në një tekst.

**Model aktiviteti** për të zhvilluar vetëdijen gjuhësore.

Mund të përdoret edhe një tekst i shkruar nga nxënësi.

### **Analiza**

Shkrimi i një nxënësi është tipik i shumë shkrimeve të prodhuara në shkollën e mesme.

Pyetjet që mund të bëhen për të rritur vetëdijen e kontekstit në një tekst të prodhuar nga nxënësi janë:

- kush e ka shkruar: është vet nxënësi apo ka bërë përshtatje të një krijimi tjetër për një qëllim të caktuar?
- kujt i drejtohet? (audienca)
- në çfarë gjinie ka shkruar? (p.sh.: tregimtare)
- në ç'kontekst është parashikuar komunikimi?

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme: dikush mund të thotë se ai është një lloj igazetarisë që synon një audiencë të përgjithshme ose një përpjekje për të bërë humor në një revistë etj. Duke dhënë disa përgjigje të mundshme në lidhje me shkrimin, puna mund të vijojë më tej, duke u përqëndruar në çështjen e vetëdijes së tekstit. Një pjesë e caktuar e tekstit mund të zgjidhet për analizë. (Mund të përzgjidhen p.sh.: 2 paragrafët e parë) Në këtë rast rileximi nuk duhet parë si korrigjim me “lapsin e kuq të mësuesit”.

Detyra duhet të përqendrohet te mënyra sesi nxënësi ka përdorur gjuhën për ta bërë atë edhe më efektive në tekstin që ka krijuar. (lexohen paragrafët e përzgjedhur)

*Pyetjet mund të përqendrohen në çështje të tilla si:*



- a) përdorimi i vetës së tretë, ai/ajo, atë, e saj, e tij etj. Cili është ndikimi i këtij përdorimi: e bën personazhin më të largët, më të dobët etj.? A është kjo e dobishme në kuadrin e tërë shkrimit? Çfarë do të arrijë: një efekt komik, ironik etj.?
- b) gjatësia e fjalive dhe lidhja e tyre; p.sh.: përgjithësisht të shkurtra, pa lidhje etj. Çfarë efekti është arritur? Disa nga fjalitë janë të pazakonta, por origjinale për shkrimin e tij, p.sh.: nuk ka folje. A duhet të ndryshohet kjo? A jep kjo një ndjenjë butësie dhe lëvizje që ndihmon në cilësinë e të shkruarit?
- c) struktura e paragrafit: ka pak fraza përshkuese dhe kohezion të brendshëm. Çfarë roli luajnë këta paragrafë?
- d) pikësimi: a duhet të rishikohet për të siguruar kuptueshmëri më të lartë?
- e) koha: përdorimi i kohëve të foljes. Çfarë efekti ka? A është ruajtur koha e foljeve në të gjithë tekstin?

Pyetjet nxjerrin në pah atë që është arritur në tekstin e shkruar. Në këtë mënyrë nxënësi inkurajohet për të reflektuar mbi përdorimin e gjuhës, zgjedhjen e fjalëve, si dhe marrjen e vendimeve për përdorimin e qasjeve alternative, të cilat mund ta bëjnë tekstin më efektiv.

E rëndësishme është që nxënësi të kuptojë se konteksti social, gjinia e tekstit dhe publiku përcakton se çfarë është më e përshtatshme dhe më efektive në fushën e regjistrimit, të sintaksës e të fjalive të përdorura.

### **3. Të shkruarit dhe të lexuarit kritik**

Gjithë puna përqendrohet në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik në tekste të gjinive të ndryshme.

#### ***Cilat janë aftësitë e të menduarit kritik?***

Në të folurit popullor termi 'kritik', është identifikuar me një

përgjigje apo vlerësim negativ.

Në kontekstin tonë dhe të përvojës bashkëkohore termi ‘kritik’ përfshin komponentët dhe veprimtaritë e mëposhtme:

- identifikimi dhe nxitja për ta marrë si diçka të vërtetë atë që tregohet në një tekst;
- rëndësia e njohjes së kontekstit dhe të kulturës për të treguar sesi tekstet përfaqësojnë dhe krijojnë përvoja;
- të imagjinuarit dhe të eksploruarit e alternativave në të gjitha kontekstet;
- zhvillimi i një qëndrimi skeptik mbi thëniet, deklaratat absolute dhe të përgjithshme;
- të analizuarit përmes pohimeve:

a. *Pohimi për faktet* ose njohuritë; në një botë që ndryshon njohuritë për faktet është mirë të merren si hipoteza, të cilat kërkojnë vërtetim të vazhdueshëm për të ruajtur statusin si të vërteta.

b. *Pohimet shkakore* që do të thotë se diçka bën që të ndodhë diçka tjetër (ndryshimi i konteksteve sjell ndryshim edhe në mesazhin që një vepër përcjell tek lexuesi.)

c. *Pohimet parashikuese*; ne bëjmë hipoteza duke u bazuar në vëzhgime apo modelet tona shkak-pasojë, bazuar edhe në atë që ka ndodhur në të shkuarën ose që ndodh në të tashmen. Kjo nuk do të thotë që parashikimet tona mund të mos jenë të gabuara (fati i gruas që sfidon moralin e kohës së saj (Ana Karenina, Ema Bovari, kënga e Desdemonës para vdekjes). Në këtë rast ne përdorim shprehjen: “kundër çdo parashikimi, fati i personazhit tonë nuk ndoqi këtë apo atë udhë”

d. *Pohimet vlerësuese*; kur pohojmë cilësinë ose vlerën e diçkaje; p.sh.: një vepre arti, një vepre letrare, figurative apo muzikore ( p.sh.: Shekspiri ka qenë poeti më i madh i botës. “Epi i Gilgameshit” është vepra më e vjetër poetike e gjetur nga lashtësia).

e. *Pohimet morale* janë gjykime për të drejtën dhe të gabuarën,

të mirën apo të keqen e sjelljes së një personazhi. Por duhet thënë se ato janë të hapura për debat, p.sh.: veprimi i Sonjës tek romani “Krim dhe ndëshkim” i Dostojevskit...; heshtja e Kolës në novelën “...Bukën tonë të përditshme falna sot”

f. *Pohimet e politikave* ofrojnë zgjidhje për problemet. Meqenëse probleme ka shumë, shumë do të ketë edhe pohime politikash. Plazhet e pastra, a janë vërtet të tilla?!, edukimi me të bukurën e nxit dhe e edukon nxënësin ta kërkojë dhe ta krijojë atë në jetë. Zbulimi i mbështetjes në folklor të artistëve shqiptarë dhe botërorë përmes hulumtimit në veprat e tyre apo thënia e poeteshës polake Vislava Shimbolska , “...Pak, shumë pak, dy në njëmijë e lexojnë poezinë” ...stimulon leximin.

g. *Pohimet e përziara*, janë thënie që i përshtaten më shumë se një pohimi, p.sh.: pohimi i Asdrenit në sonetin “Të rinjve” që u thotë brezave të ardhshëm “...faleminderit që nuk ma pranoni ndjesën...”, sepse, vërtet, nuk ka faj që 1/3 e trojeve ngeli jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë. Ne kalojmë në qëndrime; konkretisht, ne respektojmë dhe nderojmë Asdrenin për këtë qëndrim moral ndaj faktit. Në të njëjtën linjë është edhe Xhevahir Spahiu kur numëron në mes borxheve të qëna e të paqëna edhe pafuqinë ndaj 1913-ës, vitit të copëtimit të tokave shqiptare.

Në vend që të pranojë mençurinë e të tjerëve, njeriu kritik ndërton kuptime të reja që mund t’i bëjnë ballë reflektimit dhe shqyrtimit të arsyetuar.

Ai kërkon arsyet:

1. për të imagjinuar zgjidhje dhe perspektiva alternative;
2. për të bërë përpjekje dhe për të këmbëngulur në marrjen dhe integrimin e njohurive;
3. për të qenë i gatshëm të gjejë zgjidhje nga ana intelektuale dhe për të planifikuar.

**“Të menduarit efektiv nuk jepet i gatshëm, ai fitohet”**

Këto janë aftësi të të menduarit në një shkallë të lartë dhe arrihen në

mënyrë progresive. Për të qenë i suksesshëm në përfitim të këtyre aftësive duhet shumë kohë, prandaj nxënësit duhet të krijojnë besim në vetvete, në perceptimet dhe në arsyetimet e tyre, duke njohur një seri strategjish për të kuptuarit dhe të interpretuarit e teksteve.

• ***Nga pikëpamja e të lexuarit kritik:***

1. tekstet shihen si ndërtime gjuhësore, të cilat janë të ngulitura në praktikat dhe supozimet kulturore specifike;
2. tekstet marrin pjesë në mënyrën e strukturimit të shoqërisë, duke i dhënë fuqi dhe rëndësi grupeve dhe aktiviteteve të veçanta dhe ndoshta duke shfuqizuar të tjerat;
3. tekstet i drejtohen lexuesit, që ta bindin për ta parë botën në një mënyrë të veçantë;
4. të lexuarit kritik i mundëson lexuesit t'i rezistojnë “bindjes” së një teksti, të perceptojnë vlerat e tij, të hyjnë në dialog dhe në fund të fundit t'i gjykojnë këto vlera dhe supozime.

Në mënyrë të veçantë, këndvështrimi kritik i një teksti të shkruar, përfshin trajtimin e këtyre tri pyetjeve:

- pse është shkruar ky tekst?
- si është shkruar?
- ka mënyra të tjera për t'u shkruar?

Secila nga këto fusha të përgjithshme të kërkimit ndahet në një sërë pyetjesh shumë të sakta, të cilat do të shfaqen në shembujt e mëposhtëm.

*Shembulli:* Emrat, sintaksa dhe problemi i pabarazisë shoqërore

*“Në kujtim të Sotirit dhe znj. Kodra”*

(Ky mbishkrim është shkruar tek një memorial i shekullit XIX)

1. Pse është shkruar teksti?

- *Për të përkujtuar dhe nderuar dy njerëz (burrë dhe grua), që kishin vdekur.*

2. Si është shkruar teksti?

- *Ai është shkruar në një frazë retorike, deklarative që komunikon në mënyrë efektive dhe*

*nuk është një fjali e plotë. Sidoqoftë, nëse ne shikojmë më nga afër se si janë përzgjedhur dhe renditur fjalët për ndërtimin e tekstit, dalin qartë disa modele interesante.*

a) Burrit i është dhënë emri (Sotir), gruas jo. Ajo është identifikuar vetëm në marrëdhëniet e saj (si grua) pra, znj. Kodra.

Lexuesi mund të mendojë: - *Mos ndodh kjo ngaqë ka rëndësi vetëm roli i saj si gruaja e Sotirit? Është vetë teksti ai që e bën lexuesin ta shohë në këtë mënyrë.*

Ky qëndrim përforcohet edhe nga sintaksa e përdorur: renditja e fjalëve.

Sotiri është vendosur para gruas, duke theksuar përparësinë dhe pushtetin e tij.

Kujtojmë se mbishkrimi është shkruar në shekullin e 19-të, kohë kur marrëdhëniet brenda gjinive e lejonin këtë përparësi të burrit.

Ajo ç'ka tregon kjo analizë e shkurtër ka të bëjë me përdorimin e gjuhës dhe ndërtimin e teksteve si një pasqyrim i drejtpërdrejtë i attributeve dhe i sistemit të vlerave që ato përmbajnë.

3. Si mund të shkruhet teksti ndryshe?

Lexoni mundësitë e mëposhtme:

a) cilat nga këto do të ishte e pranueshme dhe e papranueshme për Sotirin?

b) cila mund të jetë e pranueshme dhe e papranueshme sot?

1. “Në kujtim të znj. dhe z. Kodra”

2. “Në kujtim të Sotirit dhe Maria Kodrës”

3. “Në kujtim të Sotir Kodrës dhe Maria Shehut, burri dhe gruaja”

4. “Në kujtim të Maries dhe Sotirit”

Secila nga këto alternativa, por dhe të tjera që mund të mendohen,

tregojnë zgjedhjen e nxënësve. Mënyra e renditjes së fjalëve i jep një pamje rolit të burrave dhe të grave në shoqëri. Ky mund të jetë një ushtrim i dobishëm për të shtjelluar me më shumë detaje këtë çështje. (*Këtu mund të sillni shembuj të dedikimeve në vepra të ndryshme letrare*).

*Shembull 2:* Identifikimi i strukturave, institucioneve apo personave të fuqishëm, nëpërmjet përdorimit të fjalëve.

Siç është thënë, një tekst bart në mënyrë të qartë os të nënkuptuar, deklarata rreth strukturave të fuqishme dhe të pushtetshme në një shoqëri. Këto deklarata reflektohen në mënyrën sesi fjalët janë përdorur në një tekst.

Një mënyrë e dobishme për ta parë një tekst nga kjo perspektivë është si vijon:

- cilët janë personat aktivë në një tekst? Cilët marrin nismën dhe cilët marrin vendime?
- ç'loj fjalësh janë të lidhura me këta njerëz?
- cilët duken si njerëz pasivë, si të pafuqishëm dhe të manipuluar?
- ç'loj fjalësh janë të lidhura me këta njerëz?
- a trajtohen njerëzit si individë apo si anëtarë të një grupi?
- si janë identifikuar këto grupe?
- çfarë supozimesh fshihen pas dhënies së identitetit të këtyre grupeve?
- për çfarë besimesh a vlerash të informon ky artikull?
- si mund të kundërshtohen këto besime?

Shikoni një artikull/shkrim nën dritën e këtyre pyetjeve. Mund të merret një artikull për tema të mprehta të shoqërisë njerëzore, p.sh.: droga, trafikimi i qenieve njerëzore etj. Përdorimi specifik i gramatikës dhe i sintaksës në çdo tekst është një reflektim i besimeve kulturore dhe i strukturave të shoqërisë, brenda së cilës jeton dhe punon një shkrimtar.

Nga kjo duket qartë sesi **vetëdija gjuhësore** dhe **të shkruarit e të lexuarit kritik** janë të ndërvarura: vetëdija gjuhësore është thelbësore për zhvillimin e qëndrimit reflektiv të të lexuarit e të shkruarit kritik dhe nga ana e tij, të lexuarit e të shkruarit kritik jep vlera morale, perspektiva sociale dhe politike për vetëdijen gjuhësore.

### ***Rëndësia e kontekstit kulturor***

Për të kuptuar tekstet është i rëndësishëm zhvillimi i vetëdijes së kontekstit të tyre kulturor. P.sh.: pa disa njohuri të epokës dhe teatrit elizabetian, të rolit të monarkisë dhe të idealeve humaniste të Rilindjes evropiane është e vështirë të vlerësojmë rolin e veprave dramatike të Shekspirit në përgjithësi, apo disa nga tragjeditë e mëdha të tij në veçanti. (kjo mund të shihet gjatë punës me një tekst të Shekspirit)

### **Tregimet dhe mbyllja e tyre**

Mënyra sesi përfundojnë tregimet (arrijnë mbylljen) tregon sesi një autor e shikon botën, duke paraqitur supozimet kulturore, strukturat sociale dhe politike, që janë ngulitur në tregim. Secila nga këto supozime mund të zbulohet nga një shumëllojshmëri perspektivash, p.sh.:

- a ndikon fokusi i tregimit?
- a është i vërtetë konteksti social dhe kulturor?
- a është romantike / reale?
- a janë personazhe të vërtetë?
- a është një ngjarje e dhunshme?
- ...etj.

### ***Interpretimi***

Tekstet tregimtare e kanë zanafillën e tyre përgjithësisht nga mitet dhe përrallat. Kur shumica e nxënësve të jenë njohur me versionet e këtyre tregimeve është me interes që, nëpërmjet analizës kritike, të bëhet krahasimi i varianteve. Kështu do të zbulohen dallimet mes varianteve, të cilat do të pasqyrojnë supozimet e ndryshme sociale dhe kulturore.

Si shembull po marrim një nga tekstet rrëfimore më të vjetra, “Epi i Gilgameshit”, ku është trajtuar pikërisht kjo çështje. Përmes këtij epi na vjen artistikisht e tërë drama ekzistenciale e frikës së njeriut nga vdekja, madje edhe kur është pjesërisht perëndi. Gilgameshi ishte i tillë. Dëshira e tij për ta mposhtur vdekjen e për të arritur pavdekësinë përbën një nga temat që ka shëtitur në letërsinë e gjithë kohërave. Nëse Gilgameshi, pas takimit me mikun e tij të shtrenjtë, Enkiduin, ndërgjegjësohet për pashmangshmërinë e vdekjes dhe kërkon ta fitojë pavdekësinë përmes veprave që lë pas, kjo frikë nga vdekja vazhdon të trajtohet ende në letërsinë moderne. Letërsia e shekullit XX ndalet posaçërisht në këtë çështje. Thelbi i absurdit trajton pikërisht pashmangshmërinë e vdekjes dhe kotësinë e të gjitha përpjekjeve që bën njeriu modern për t’i shpëtuar asaj; ai është i destinuar që nga lindja të jetë i vdekshëm. Sigurisht, kjo letërsi i kundërvu asaj zgjidhjeje që ofroi ardhja e Krishterimit, ku mbylljet e tregimeve u përshtatën për të forcuar besimin në një tjetër jetë. Letërsia mesjetare ofroi shumë vepra për shenjtorë apo vdekatarë të zakonshëm, ku personazhi kthehet në të krishterë dhe vdes i lumtur. Alternativat e mbylljeve të rrëfimeve gjatë shekujve në vazhdim janë të ndryshme, që nga Rilindja evropiane, klasicizmi, romantizmi dhe deri në ditët tona. Prandaj materiali që silllet në klasë, mit, ep, legjendë apo tregim qoftë mund të shihet dhe të interpretohet nga pozita të ndryshme. Interpretimi varet nga këndvështrimi i lexuesit. Këtu janë disa qëndrime të mundshme:

***Pozicioni psikologjik:*** përmbajtja e “Epit të Gilgameshit” është një histori që vjen deri në maturim, në fazën e pjekjes ku heroi psikologjikisht



përgatitet për kufijtë e tij ekzistencialë dhe i transponon energjitë dhe kënaqësinë e tij drejt bëmave që fitojnë ekzistencë objektive përtej kufijve të vdekjes. Në terma frojdian, Epi tregon një shpirt individual, atë të Gilgameshit, që lëviz nga parimi i kënaqësisë (arratisja, *përpyjekja për sunduar jetën dhe vdekjen* , vetëkënaqësia, kënaqësia, individualiteti i spikatur), te parimi i realitetit (detyra, shërbimi, përgjegjësia, kërkesa, puna).

**Pozicioni feminist:** si zakonisht në shoqëritë patriarkale, gruaja tregohet joshëse. Ajo shfaqet si një qenie e bukur dhe e rrezikshme, larg nga bota reale, ndonjëherë e pranishme për t'u shërbyer nevojave të meshkujve. Tek "Epi i Gilgameshit" ajo dërgohet nga Perënditë për të joshur mashkullin që ai të dalë nga pylli e të luftojë forcat e errëta. Ky rol "qytetërues" jo gjithmonë i është njohur femrës në krijimet letrare popullore apo të kultivuara. Jo rrallë gruaja është dhënë kryesisht pasive, nuk merr vendime të rëndësishme dhe për këtë arsye është parë vetëm si një mbështetëse në veprimet e heroit. Këtu sigurisht bën përjashtim një radhë shkrimtarësh të mëdhej që shquhen për pozicione feministë, p.sh.: Henrik Ibsen për të ardhur në shoqërinë moderne në të cilën thyhen stereotipat gjinorë.

**Pozicioni fetar:** në ep gjallon një sistem i tërë politeist (shumë perëndish), që do të thotë se shoqëria njerëzore në fëmijëri të saj zotërohet për periudha të gjëra kohore nga besimi pagan, i cili nuk u dha një përgjigje të mirëfilltë pyetjeve themelore të jetës. Ajo shoqëri shënon një shkallë të ndërgjegjësimit njerëzor fillestar, e cila merr trajtë në antikitetin grek përmes sistemeve filozofike, përsëri naive. Në rrjedhën e shekujve do të ishte shndërrimi në të krishterë që shënon një hap drejt besimeve monoteiste dhe që kujdeset për ruajtjen e shpirtit njerëzor, duke i dhënë mundësi të vdesë i kënaqur me besimin e ri dhe i sigurt te jeta e përhershme. Në fondin e letërsisë greke, njerëzit shkojnë në Had dhe vetëm me krishterimin bota e përtejme ndahet në shpërblyese, Parajsa, dhe ndëshkuese, Ferri. Trajtimi i teksteve nga perspektiva të ndryshme u jep mundësi nxënësve të

shohin një shumëllojshmëri kuptimesh brenda tyre. Kjo i inkurajon ata që të reflektojnë dhe të bëhen të vetëdijshëm për pozitën e tyre interpretuese. Gjithashtu, duhet theksuar se një tekst nuk bart vetëm një kuptim të veçantë e të përcaktuar: ***kuptimet gjenerojnë nga “përballja” e lexuesit me tekstin.*** Dialogimi është pjesë jetike në përcaktimin e domethënies/kuptimit.

## **Tekste vizuale/gojore**

Qasja e leximit kritik është e zbatueshme për të gjitha tekstet e dëgjuara, të shkruara ose vizuale. Aplikimi i saj te tekstet vizuale është më i rëndësishëm për studimin krahasues. Ashtu si tekstet e shkruara, edhe tekstet vizuale janë ndërtime të qëllimshme; p.sh.: karikatura politike është një gjini e veçantë ose lloj teksti. Ajo kombinon aspektet verbale dhe vizuale. Është e njohur për stilin e saj të vizatimit (karikaturë/vizatim i keq) dhe i referohet ngjarjeve aktuale. Qëllimi i saj është në përgjithësi argëtues dhe satirik. Në shqyrtimin e karikaturave politike duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

1. *Aspektet vizuale*: personazhet paraqiten të vizatuar keq dhe me detaje të veshjes, të vendndodhjes së tyre etj.
2. *Aspektet verbale*: përdorimi i sloganeve, i fjalëve dhe i copëzave të fjalimeve të tyre.
3. *Konteksti socio-politik dhe kontekste të medias*. (Jepet një karikaturë për konkretizim. Analiza e mëposhtme është për një karikaturë imagjinare.)

## **Aspektet vizuale**

Karikatura: figurat janë personazhe të njohura; versioni i thjeshtëzuar i paraqitjes së tyre thekson detajet që japin imazhin e një karakteri të veçantë p.sh.: pamja fizike, veshja, shprehjet e fytyrës etj.

## **Aspektet verbale**

Fjalët në një karikaturë politike përforcojnë kuptimin e tekstit vizual. P.sh.: përfytyrojmë një karikaturë ku jepet një politikan që premtun për ambientin gjatë fushatës. Këtu, pozita ironike e “ambientalistit” mund të paraqitet në mënyrë komike nëpërmjet paaftësisë së politikanit për të pranuar atë që kërkon të mbrojë dhe mendimit të tij se mjedisi është diçka vetëm rurale.

- Si ndikon kjo ironi e tij në perceptimet tona?
- A është ai një premtues efektiv në fushatën e tij?
- Cila është pikëpamja e karikaturistit?

Konteksti socio-politik dhe media

Kjo karikaturë paraqitet në një revistë satirike. Syri i lirë i një qytetari shqiptar sheh gjatë viteve 1990 modele të ndryshme politikanësh, ku një vend zënë edhe ata që premtojnë “qiqra në hell”.

***Të lexuarit dhe të shkruarit kritik nuk zëvendëson metodat tradicionale, por ofron një perspektivë shtesë për trajtimin e teksteve***

Qasja kritike e teksteve do të shihet si një dimension tjetër, që ndihmon nxënësit për të parë sesi tekstet janë të vendosura në kontekste të ndryshme kulturore. ajo i pajis nxënësit me aftësinë për ta lexuar dhe për t’iu përgjigjur “botës” së krijuar në tekst me më shumë kuptim dhe me më shumë ndjeshmëri. Autori nuk shkruan në një zbrazëti kulturore dhe lexuesi nuk lexon në një zbrazëti kulturore. Zhvillimi i vetëdijes dhe interpretimi i teksteve është shumë i rëndësishëm për studimin e gjuhës dhe të letërsisë. Në kontekstin e studimeve krahasuese të reja, qasja është e një rëndësie të veçantë.

• **Qasje metodologjike për mësimdhënien e aftësive të të kuptuarit dhe të krijuarit në lloje dhe forma të ndryshme**

***“Nuk është vetëm një mënyrë të shkruari dhe të lexuari, ka shumë të tilla në botën e sotme “***

## **GJUHA E INFORMACIONIT**

Kjo mënyrë të shkruari kërkon që:

***Informacioni maksimal të jepet me minimumin e fjalëve.***

Gjuha duhet të jetë transparente, e saktë dhe struktura e tekstit e qartë. Kjo është mënyra ideale. Në këtë kategori përfshihen përmbledhjet e shkurtra ( memot) për nevoja qytetare /biznesi, raporte dhe përshtypje sportive, kulturore, turistike, komente për arritjet shkencore etj.

A. Për ilustrim mund të përdoret një shkrim nga gazeta; në të cilin jepen të dhëna mbi turistët në Shqipëri; pra një raport faktik nga gazeta.

*Të kuptuarit*

Ky raport mund të jetë i dobishëm, pasi u zhvillon nxënësve aftësi specifike, si: identifikimi i thelbësore, detajet specifike.

*Aftësitë që zhvillohen:*

1. Dhënia e thelbit në një fragment, pra “lënda” e përgjithshme dhe këndvështrimi;
2. Përcaktimi i detajeve specifike;
3. Analizimi i zhanrit;
4. Stili;
5. Leximi dhe shkrimi kritik.

*Metoda që mund të përdoret:*

1. Krijoni situatën e kontekstit, diskutoni për pak kohë dhe pastaj lexoni tekstin.
2. Detyrë për nxënësit: vendosini një titull tekstit. (Nxënësit rilexojnë tekstin për këtë qëllim)

3. Tregoni kuptimin/domethënien e thelbit. Kjo mund të bëhet duke iu përgjigjur fillimisht pyetjeve:

- a) cili është argumenti, tema apo subjekti i këtij teksti ?
- b) ç'dini për autorin?

Pyesni, p.sh.: Për ç'arsye u rrit numri i vizitorëve këtë vit në Shqipëri?

Kërkojuni nxënësve:

- të shënojnë frazat / fjalitë që e tregojnë këtë;
- të gjejnë arsyet/shkaqet e rritjes së numrit të vizitorëve në tekstin e dhënë, duke vënë lidhëzën “sepse” para secilës.

Pasi të kontrollojnë gjetjet e tyre, nxënësit mund të shkruajnë një paragraf përmbledhës. Në tekstin ( raportin) e dhënë mund të analizohen llojet e fjalive dhe të thënieve në pjesë të ndryshme. Teksti ndahet në pjesë:

Pjesa 1: Thënie të përgjithshme të mbështetura në statistika dhe ilustrime.

Pjesa 2: Arsyet specifike dhe citime.

Pjesa 3. Klasifikime, ilustrime

Pjesa 4.....

Pjesa 5....etj.

*Përcaktohet:*

a) *toni*, p.sh.: neutral, objektiv b) *regjistri*, p.sh.: ka fjalë e shprehje të fushës së turizmit e biznesit, të tilla si: rezervime, broshura, vende të kërkuara, opsione për pushime etj.

Nxënësve mund t'u kërkohet të reflektojnë mbi arsyet e shkrimit të këtij teksti/raporti.

- Ç'efekt do të ketë një raport i tillë?
- Ka interes një përlllogaritje e tillë?
- Ç'prova/të dhëna/informacione mund të përdorin nxënësit për të mbështetur pikëpamjet e tyre?

### *Të kuptuarit*

Shkrimi tregon se në një tekst informativ, faktet jepen me minimumin e fjalëve. Janë paraqitur prova të ndryshme dhe në mënyrë të përmbledhur për të mbështetur pohimin e përgjithshëm dhe për të mbajtur gjallë interesin e lexuesit.

### *Të krijuarit*

Nxënësve mund t'u jepet detyra e mëposhtme:

- Shkruani një raport mbi një temë që lidhet me zgjedhjet/interesat e tyre, p.sh.: programe televizive, muzikë, sport etj.
- Raporti duhet të jetë i shkurtër, 3-6 paragrafë bazuar në disa kërkime aktuale.

Struktura e raportit mund të jetë si më poshtë:

1. titulli;
  2. pohimi i përgjithshëm me disa prova/ të dhëna mbështetëse;
  3. arsyet / shkaqet pse po trajtohet kjo çështje;
  4. konkluzioni: mbyllja të jepet me koment vlerësues.
- Bëni prezantimin e një (ose më shumë) raporti në klasë.

*Vlerësimi:* Për vlerësimin e detyrës duhet të përdoren si kritere të katër elementet e modelit. Duhet t'i kushtohet kujdes vlerësimit me saktësi të sintaksës, drejtshkrimit e pikësimit. Katër elementet e modelit do të tregojnë arritjet dhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit në këtë lloj të shkruarit, si dhe do të ndihmojnë mësuesit ku duhet të përqëndrojnë punën e tyre në të ardhmen.

### *B. Deklarata publike*

Në këtë rast mund të përdoren deklarata zyrtare të figurave të njohura për çështje të ndryshme, p.sh.: për pyjet, ambientin, energjitikën, arsimin, të

drejtat e njeriut etj.

Si shembull mund të merret një deklaratë zyrtare e bërë nga X.Y për pyjet.

Fillimisht duhet përcaktuar qëllimi i tekstit:

- për të bërë një deklaratë politike,
- për të vendosur disa objektiva,
- për të dhënë udhëzime,
- për të bërë paralajmërime.

### *1. Të kuptuarit*

Teksti mund të përdoret për të mësuar një shumëllojshmëri të teknikave të të kuptuarit; p.sh.: identifikimi i strukturës dhe i formatit; përmbledhja; gjetja e detajeve të rëndësishme; vetëdija e regjistrimit.

### *Aftësia*

Përmbledhja

### *Metodologjia*

- a) Krijoni një situatë të përshtatshme për temën që trajtohet; prezantoni tekstin.
- b) Ndajni tekstin në pjesë; gjejnë titullin për çdo pjesë.
- c) Kërkojuni nxënësve të bëjnë një përmbledhje të asaj që *lejohet* dhe që *nuk lejohet* për pyjet.

Tregojuni nxënësve procedurën që do të ndjekin:

- a. ndarja e tekstit në pjesë;
- b. gjetja e paragrafëve dhe e fjalive përkatëse;
- c. grupimi i fjalive në: ***lejohet, nuk lejohet;***
- d. shkruani dy paragrafë për të përmbledhur përfundimet.

## *2. Të krijuarit*

Nxënësve tani mund t'u kërkohet të shkruajnë:

1. udhëzime dhe vërejtje për përdorimin e ndonjë objekti;
2. një seri udhëzimesh zyrtare që pasqyrojnë politikën e shkollës në lidhje me disa nga aspektet e sjelljes së nxënësve.

## *Aftësia*

Vetëdije e regjistrimit

Shkrimi dhe leximi kritik

## *Metodologjia*

Nxënësit kanë mundësi të dyfishta në lidhje me stilin dhe regjistrimin e tekstit:

- personale / e papërcaktuar
- joformal / formal
- bisedor / ligjor
- deklaratë/ urdhër
- e thjeshtë / komplekse
- specifike / e përgjithshme
- ton i njëjtë / ton i ndryshëm
- folje veprorë / folje joveprorë

Kërkojuni nxënësve të zgjedhin ato që mendojnë për të përshkruar gjuhën e fragmentit. (Kjo mund të paraprihet nga mësuesi duke modeluar ushtrime me disa fjali: p.sh.: Ju lutemi, ecin në trotuar! Mos shkelni mbi bar! Dhunuesit do të ndiqen penalisht etj.) Ky mund të përshkruhet si një regjistër ligjor që përdoret në udhëzime dhe paralajmërimet e përcaktuara. *Fjalitipike/struktura e frazave*: foljet pasive, frazat teknike, strukturat komplekse sintaksore



Frazat karakteristike:

Të gjithë personat që hyjnë. . .

. . . nuk do të jetë përgjegjës. . .

kujdesem. . .

Mos. . .

Në mënyrë që. . .

A janë të lejuara. . .

*Toni* i pjesës, p.sh.: është midis këshillës së singertë, urdhrin të drejtpërdrejtë

dhe bindjes së butë.

1. Kërkojuni nxënësve të formulojnë pyetje që mund t'ia bëjnë autorit të këtij teksti.

2. Kërkojuni nxënësve të bëjnë supozime rreth tekstit.

Sqarojini ata se është një tekst zyrtar. Cila është pozita sociale, kulturore ekonomike e autorit? Si tregohet kjo në gjuhën e përdorur? Kërkojuni nxënësve të nënvizojnë fjalët dhe frazat që të zbulojnë këto pozita. Një ushtrim i vlefshëm për një tekst të tillë është që nxënësitarish kruajnë atë me një stil më pak ligjor. Më pastë diskutojnë indikatorndryshimi i gjuhës të rezultateve.

*Vlerësimi*: Elementet e modelit rekomandohen si kritere vlerësimi në këtë detyrë.

Materiale për studime të mëtejshme të këtij lloji teksti mund të jenë:

- rregullat për hyrje në konkurse;
- rregullat për të luajtur lojëra;
- udhëzime për përdorimin e llojeve të ndryshme të pajisjeve;
- dokumente zyrtare dhe njoftime publike;
- materiale të mediave të llojeve të ndryshme: gazeta, radioja dhe televizioni.

## GJUHA E ARGUMENTIT

*“Qëllimi i argumentit. . . nuk duhet të jetë fitorja, por progresi”*

Një argument për shumë njerëz është i identifikuar me një “sherr”. Kjo nënkupton refuzimin e paepur për të të pranuar mendimin e të tjerëve dhe një refuzim total për të ndryshuar diçka nga këndvështrimi yt. Në përgjithësi nxënësit gjejnë vështirësi për të mësuar argumentin. Gjithashtu, aftësitë e kërkuara janë abstrakte, ndaj duhet përqendrim dhe disiplinë për menazhimin e tyre; duhen evidenca të zgjedhura, mendim i strukturuar dhe lidhje logjike. Aftësitë e të menduarit janë të një niveli të lartë dhe përfshijnë analizën, sintezën dhe vlerësimin. Për më tepër, nxënësit kanë vështirësi në përdorimin e fjalëve dhe frazave lidhëse, p.sh.: *për shkak se, prandaj, në anën tjetër etj.*, të cilat janë esenciale për një argumentim të suksesshëm. Me qëllim që nxënësit ta zhvillojnë natyrshëm këtë aftësi, të mësuarit e argumentit duhet të bëhet në mënyrë të strukturuar për të futur nxënësit në proceset e mendimit logjik.

### ***Bazat e argumentit***

Nxënësit duhet të njihen me dy lloje argumentesh: deduktiv dhe induktiv. Këto duhet të dallohen nga thëniet e opinionit, të cilat mund të merren si forma deduktive dhe induktive. Është mirë që të shihen në vazhdimësi rastet e argumentit dhe të opinionit për të konstatuar se kur dhe ku zhvillohen ato:

#### ***Argumenti***

Objektiv

Fakte

Dëshmi e provueshme

E papërcaktuar

Interpretimi

#### ***Opinionit***

Preferenca subjektive

Pohime

Supozime

Personale

Interpretimi

### ***Argumenti deduktiv***

Zgjidhni një temë, p.sh.: forma e Tokës

A) Një argument deduktiv ka një strukturë të veçantë logjike.

1. Një parim i përgjithshëm (në rastin konkret për formën; p.sh.: të gjithë planetët në sistemin diellor janë sferikë).
2. Bën një deklaratë të veçantë; p.sh.: toka është një planet në sistemin diellor.
3. Nxjerr një përfundim nga 1 dhe 2; p.sh.: prandaj toka është sferike.

*Shembull* për një argumenti deduktiv:

1. Të gjithë planetët në sistemin diellor janë sferikë.
2. Toka është një planet në sistemin diellor.
3. Prandaj Toka është sferike.

B) Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë këtë mënyrë të menduarit.

*Aktivitet:* Identifikoni opinionin. Shpjegoni zgjedhjen tuaj.

a.

Gjithë ishujt janë të rrethuar nga uji. Të gjithë mësuesit janë të stresuar  
Sazani është i rrethuar nga uji. Ada është një mësuese.

Prandaj ai është një ishull.

Prandaj ajo është e stresuar.

c.

Njerëzit që shikojnë televizor shumë kanë një përqendrim të shkurtër.

Enja shikon televizor tetë orë në ditë.

Prandaj Enja ka një përqendrim të shkurtër.

*Opinionet* janë struktura logjike, ato kanë edhe një strukturë korrekte të të arsyetuarit, por kjo nuk do të thotë se c'ka thonë është domosdoshmërisht e vërtetë dhe e drejtë. Një thënie mund të ketë strukturë korrekte, por njëherazi të jetë e gabuar, p.sh.:

*Të gjithë tigrat janë mace (i takojnë familjes së maces)*

*Kafsha jonë shtëpiake është një mace.*

*Prandaj ajo është një tigër.*

Megjithëse struktura e saj është e saktë, ky argument është i gabuar, sepse konkluzioni i arritur nuk është i drejtë. Argumenti i merr kafshët sikur janë të njëjta.

*Aktivitetet:*

Nxënësve mund t'u kërkohet të rendisin shumë shembuj sipas këtij modeli :

*E vërtetë*

*E gabuar*

A. Një përzgjedhje e këtyre mund të analizohet si më poshtë:

- a është ky një argument apo një opinion?
- a është logjikisht i saktë?
- a është i vërtetë?

P.sh.: Çfarë është e gabuar në shembujt e mëposhtëm?

Disa infermiere janë gra.

Iva është një infermiere.

Prandaj Iva është një grua.

B. Shto fjalinë që mungon duke ruajtur vijueshmërinë logjike.

- 1) Të gjithë nxënësit maturantë i nënshtrohen Maturës Shtetërore.
- 2) Ada është një maturante.

.....

- 1) Të gjitha shkollat janë pajisur me qendra informatike.
- 2) Shkolla “Qemal Stafa “ është një ndër gjimnazet e Tiranës.

.....

## ***Argumenti induktiv***

### *Toka është e rrumbullakët*

Ka shumë arsye për të pohuar se toka është e rrumbullakët:

1. para se Dielli të ngrihet në horizont, fillimisht ndriçon retë, pastaj ndërtesat e larta. Kjo gjë shpjegohet me mysëtinë e tokës, si pasojë e së cilës vendet e ulëta ndriçohen më vonë.

2. hija e Tokës gjatë eklipsit të Hënës, d.m.th kur Toka ndodhet midis Diellit dhe Hënës është hark rrethi. Hije të tilla mund të lëshojnë vetëm trupat sferikë.

3. nëse një vrojtues ngjitet lart, shikimi i tij përshkon një hapësirë gjithnjë e më të madhe, d.m.th. horizonti i tij zmadhohet. Kjo gjë tregon se Toka është e mysët.

4. pamja nga sateliti e tregon formën e saj sferike.

5. të gjithë trupat e sistemit diellor, Dielli, Hëna etj. kanë formë sferike, prandaj dhe Toka nuk bën përjashtim.

Siç e pamë më lart, një argument induktiv është i bazuar në të dhëna të veçanta dhe raste nga të cilat del një përfundim. Ajo bazohet në një analizë të provave, e cila pastaj mund të përmbliidhet si një konkluzion.

Një argument induktiv zakonisht ka strukturën e mëposhtme:

1. Deklarimi i tezës / i propozimit / i pyetjes;
2. Paraqitja e provave, e shembujve;
3. Përfundimi.

### *Shembull për argumentin induktiv:*

*Në qoftë se në dimër vërejmë se një numër i pemëve të dushkut humbasin gjethet e tyre, atëherë dalim në përfundimin se të gjitha pemët e dushkut humbasin gjethet e tyre në dimër. Por arsyetimi induktiv mund të jetë edhe i rremë. Një pjesë e provave të kundërta mund të dëmtojnë përfundimin dhe të tregojnë që modeli nuk është i*

saktë. Kërkojuni nxënësve të sugjerojnë disa prova, të cilat mund të sfidojnë përfundimet e arritura në argumentet induktive të mësipërme. ***Për të patur rezultat të dy argumentet, induktive dhe deduktive, duhet të bazohen në fakte të vërtetuara dhe dëshmi të provueshme.***

### ***Opinioni***

Opinioni është shprehja e mendimit nga një këndvështrim i bazuar në supozime, arsye dhe interpretime subjektive. Mendimi mund të jetë i mirëinformuar dhe koherent ose jo. Mendimi koherent duhet të marrë një nga format argumentuese të përshkruara më lart.

Ilustrim:

*A. Opinioni në formë deduktive:*

*Pyetje:* Kush është lojtari më i mirë i viteve të fundit për ekipin e futbollit shqiptar?

*Parimi:* Lojtari më i mirë në një ekip është ai që ka rezultatet më të larta.

*Shembull specifik:* X,Y ka shënuar më shumë gola.

*Konkluzioni:* Prandaj X,Y është lojtari më i mirë në ekipin shqiptar.

*B. Opinioni në formë induktive:*

*Teza:* Berati është qyteti më tërheqës për turistët

*Arsyet:* (Sepse)

- peizazhi;
- ka një traditë të madhe të ndërtimeve karakteristike;
- kalaja e Beratit me kishën më të vjetër;
- lagjja brenda kalasë;
- lumi Osum përshkon mes përmes qytetin;
- populli i tij është miqësor dhe mikpritës;

*Konkluzioni:* (Prandaj) Berati është qyteti më tërheqës për turistët.

### C. Opinioni inkohorent

Opinionin *inkohorent* është një seri pohimesh sipas një këndvështrimi ku mungon struktura logjike, detajet e lidhura dhe informacioni i duhur. p.sh.: *Unë mendoj se X.Y është lojtari më i mirë. Ai vjen nga Gjermania dhe luan për ekipin kombëtar. Ai fiton shumë para dhe është i mirë për familjen e tij.*

#### *Të krijuarit*

Nxënësve mund t'u jepen detyra që të renditin argumente të thjeshta induktive dhe deduktive për një sërë temash, p.sh.: Cili është programi më i këndshëm në televizion?

Fillimisht mësuesi duhet të përcaktojë procedurat.

*Së pari*, zgjidhni temën, e cila është hapi i parë për arsyetimin deduktiv, p.sh.: Cili është programi më i këndshëm në televizion?:

1. *Gjeni parimin*: Programi më i këndshëm në TV është ai që ka audiencën më të madhe
2. *Forma specifike*: Emisionet Shoë kanë audiencë më të madhe
3. *Konkluzioni*: Prandaj emisionet Shoë janë më zbavitëse. . .

Procedura për arsyetimin induktiv:

1. *Teza*: Programi X është Shoë më zbavitës.
2. *Gjej të dhënat/provat*:
  - shumë njerëz e shohin çdo javë;
  - ai ka personazhe interesante;
  - trajton gjithmonë një ngjarje të bukur dhe interesante për grupmosha të ndryshme;
  - ngre çështje të rëndësishme sociale;
  - është më zbavitës.
3. *Konkluzioni*: Programi X është më. . .

Një ushtrim themelor në shqyrtimin e argumentit është të dalluarit

e faktit nga pohimi; dëshmisë nga mendimi. Mund të punohen shembuj të ndryshëm për këtë qëllim.

*Shembull: Vlerësimi i një argumenti*

Mund të merret një shkrim që trajton probleme të mprehta sociale; p.sh.: fëmijët pa prindër, gratë e divorcuara, papunësia etj.

*Të kuptuarit*<sup>3</sup>

Ky artikull është strukturuar si një argument induktiv, bën një deklaratë të fortë të vlerave dhe paraqet një shumëllojshmëri të të dhënave. Kombinon një pikëpamje personale me të dhëna objektive, një bilanc që nuk menazhohet lehtë. Në stil ai është një përzierje e formales me joformalen.

*Të krijuarit*

Nxënësit kanë parë modelin e një argumenti induktiv, të cilin duhet ta imitojnë. Ata mund të bëjnë një detyrë ku të kundërshtojnë pikëpamjet e shprehura në këtë artikull.

Ja një model i arsyetimit induktiv që mund të ndiqet nga nxënësit:

1. deklarimi i tezës /i pozicionit / i këndvështrimit;
2. paraqitja e provave: fakte, shembuj, ilustrime etj;
3. përfundimi: riformulimi i tezës me më shumë forcë.

*Vlerësimi:* Përdorimi i kësaj strukture duhet të jetë i detyrueshëm. Ajo mund të përdoret për të vendosur disa kritere për vlerësimin e të shkruarit të nxënësve. Është mirë që nxënësit të inkurajohen për t' i zbatuar këto struktura gjatë të shkruarit dhe për vlerësimin e punës së tyre në këtë fushë të krijimit.

---

Komentet janë të supozuara. Është vetëm një model. Ju do t' i përmbaheni materialit tuaj konkret mbi të cilin do të punoni.



*Aktivitet:* Dallimi mes argumentit dhe opinionit/mendimit.

Mund të merret një shembull në të cilin është përdorur edhe argumenti, edhe opinionin me qëllim që nxënësit të punojnë për të bërë dallimin mes tyre.

### *Aftësia*

- Përshkrimi i fazave të argumentit.
- Identifikimi i strukturës së arsyetimit.
- Identifikimi i supozimeve dhe vlerave të tyre.

### *Metodologjia*

Prezantoni artikullin/shkrimin. Pas leximit fillestar, kërkojuni nxënësve:

1. të gjejnë deklarata/thënie të përgjithshme të këndvështrimit të autorit;
2. të zgjedhin disa paragrafë që paraqesin të dhëna mbështetëse; Identifikoni të dhëna të përfshira në këta paragrafë; p.sh.: fakte, shembuj, ilustrime.

Vendosni një titull për çdo paragraf.

### 3. Mbyllja

Së fundi, nxënësit të shkruajnë një përmbledhje në formën e mëposhtme:

1. tema
2. tri fjali që paraqesin të dhëna sipas këndvështrimit vetjak
3. mbyllja.

Kërkojuni nxënësve një listë me argumente pro dhe kundër pikëpamjes së autorit për çështjen që është trajtuar në artikullin/ shkrimin e tij.

*Aktiviteti* punohet mbi një tekst të planifikuar nga mësuesi.

### *Të kuptuarit*

Disa çështje për diskutim:

- cilat janë fjalët kyçe ose frazat që bartin mesazhin kryesor të tekstit?
- listoni disa prej tyre.
- identifikoni tezën/çështjen e përgjithshme. Përmbliidheni atë me një fjali.
- ç'të dhëna janë përdorur për të mbështetur këtë tezë? Ç'lloj janë: fakte, ilustrime, anektda, shembuj?
- ç'konkluzion është arritur?
- a është ky një tekst koherent apo mund të identifikohet edhe ndonjë mungesë lidhjeje?
- në ç'gjini është shkruar teksti?
- a është ky një argument apo një shprehje e opinionit?
- pse është shkruar ky tekst: për të provokuar përgjigje , b) për të shprehur zhgënjim, c) për të shprehur zemërim, d) për të shitur gazetën etj.?
- çfarë vlerash dhe supozimesh nënkuptohen në këtë tekst?

### *Të krijuarit*

Shkruani një artikull për një revistë të njohur që mbështet apo kundërshtn këndvështrimin mbi tekstin.

## **GJUHA E BINDJES**

Edhe pse argumenti dhe bindja janë të ngjashme, ato mund të dallohen nga njëri-tjetri. Të dyja kanë për qëllim bindjen e dikujt, të ndryshuarit e mendjes së dikujt për një çështje, por për të realizuar qëllimin e tyre ato përdorin qasje dhe teknika të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se janë reciprokisht përjashtues.

*Argumenti* mbështetet në qasjet racionale, logjike, ndërsa *bindja* përdor qasje joracionale të tilla, si: sugjerim, sensacion dhe teknika të tjera manipuluese.

*Gjuha e bindjes* është fuqimisht pranishme në botën e medias, politikës dhe reklamave. Ajo është gjuha karakteristike e atyre që kërkojnë të arrijnë ose të mbajnë pushtetin në disa fusha. Qasjet e të mësuarit në këtë fushë duhet të përqendrohen në teknika që i bëjnë tekstet si mjete të fuqishme bindëse.

***Qasjet në mësimdhënien e bindjes:***

Një tekst bindës duhet të përqendrohet në një audiencë të zgjedhur. Kjo do të përcaktojë përmbajtjen edhe formën e tekstit. Tekstet bindëse janë ndërtime në të cilat ndjenja, imazhi dhe fjala janë formuar në mënyrë që ato të manipulojnë emocionet dhe imagjinatën e publikut për të arritur marrëveshje dhe pëlqim/konsensus.

*Shembull:* Krahasimi i teksteve bindëse.

1. Lexoni dy tekste që kanë qëllime të ndryshme, por të dyja përdorin teknika të ngjashme për të bindur lexuesit.
2. Shënoni çdo ngjashmëri mes tyre.

Duke lexuar të dy tekstet, diskutoni këto pyetje:

- cila është audiencia për secilin tekst?
- kush e ka shkruar tekstin dhe pse?
- a është ky një tekst koherent dhe efektiv?
- a është bindës për rrjedhën e veprimit? Po/ Jo? Pse?
- në ç'zhanër është shkruar secili prej tyre?

*Disa teknika të përgjithshme bindëse:*

- a) *Toni:* qëndrimi i shkrimtarit ndaj një audience është i larmishëm dhe mund të ndryshojë, p.sh.: reklamat tentojnë të përdorin magjepsjen.
- b) *Imazhet dhe anekdotat:* përdoren si dëshmi, ose për të bërë përshtypje e për të lënë gjurmë të qëndrueshme emocionale.
- c) *Detaje sensacionale:* kujtoni shembuj të lajmeve nga gazeta, nga radioja a televizioni, fjalime politike kur sulmohen kundërshtarët.

d) *Ritmi dhe përsëritja e fjalëve* përforcon këndvështrimin e autorit.

Shpesh autori zbulon një frazë të paharrueshme. Shembull i një fraze të famshme mund të jetë:

“Unë kam një ëndërr”.

“Ne do të fitojmë” (Martin Luter King)

“Po, unë mundem” (Barack Obama)

Këto janë të paharrueshme për shkak të ritmit të tyre të rregullt dhe formës së ngjeshur. Në shoqërinë bashkëkohore, tinguj dhe reklamat joshëse janë shembuj teknikë të këtij veprimi që realizojnë bindjen në mënyrë më të shpejtë.

e) *Humori*: krijon një ndjenjë miqësie mes folësit / shkrimtarit dhe audiencës. Në këtë mënyrë ata kanë tendencë për të fituar audiencë përtej pikëpamjeve të shprehura. Humori mund të jetë në shumë forma, si: shaka, anekdota, karikatura të shpejta, komente ironike etj. Të gjitha këto drejtohen nga emocionet dhe imagjinata. Ato synojnë orientimin e ndjenjave në një mënyrë të veçantë. Argumenti logjik mund të jetë pjesë e një teksti bindës.

### ***Analiza e një teksti bindës***

*Pjesë nga “Jul Çezar” i Shekspirit*

*Fjalimi i Mark Antonit, drejtuar popullit romak.*

Ashtu si një argument i suksesshëm, edhe një tekst bindës duhet të jetë koherent. Edhe pse ndërtimi logjik nuk ka nevojë të jetë i përsosur, në mënyrë të qartë, ai nuk duhet të jetë kontradiktor. Elementet emocionale dhe imagjinare janë të rëndësishme për një bindje të suksesshme. Për më tepër, është jetike përshtypja që bën folësi /shkrimtari te publiku.

### ***Të krijuarit***

Nxënësit zgjedhin temat e tyre, mundësisht disa çështje për të cilat ata kanë këndvështrime të qarta. U jepet detyrë të shkruajnë

një artikull apo një fjalim të shkurtër mbi këtë temë. Audiencia duhet të jetë qartësisht e përcaktuar: mësuesi, prindi, klasa, publiku i gjerë.

Krijimi duhet të ketë formën e mëposhtme:

- qëllimi;
- këndvështrimi i autorit;
- imazhet që krijojnë ndjenjat për çështjen e caktuar;
- interpretimi i imazheve për të mbështetur këndvështrimin;
- mbyllja.

### *Aftësia*

- Ndërgjegjësimi i audiencës.
- Imazhet.
- Përsëritjet.
- Struktura logjike.

### *Metodologjia*

Krijoni në mënyrë imagjinare situatën e përballjes së Mark Antonit, p.sh.: turma armiqësore, gjaketur, e varfër, e shtypur dhe e paarsyeshme.

- Si dalin të gjitha këto te fjala e tij?
- Si e fiton ai simpatinë e turmës?

a) Ai këmbëngul se është si ata.

b) Gjuha e përdorur: ka shumë detaje që ndikojnë te audiencia.

Kërkojuni nxënësve të japin imazhin e Çezarit të krijuar në mendjen e tyre.

Çfarë ndjenjash ka për Mark Antonin në imazhin e tyre?

- Pse këto ndjenja? Cilat ngjarje krijojnë ndjesi për një mbret?
- Çfarë lloj ndjenjash të ngjallin këto ngjarje?
- Ç'gjurmë lë përdorimi i frazës “burrat e nderuar” gjatë fjalimit?
- Cili është kuptimi i saj në kontekstin e përdorur? Si ndikon te fjala në

vazhdimësi? Në një fjalim të mëparshëm Bruti kishte thënë se Çezari ishte ambicioz.

- Tregoni me detaje të hollësishme, duke u bazuar në interpretimin e ngjarjeve të caktuara, se si Mark Antoni paraqet tradhtinë e Brutit.

### *Sugjerim metodologjik*

Mësuesi duhet të japë në vijim një model të veçantë për të përforcuar të kuptuarit e zhanrit nga nxënësit. Kjo mund të realizohet edhe si një detyrë e përbashkët në klasë. (Më poshtë po japin disa sugjerime për ta realizuar këtë detyrë)

1. Zgjedhja e temës, p.sh.: shfrytëzimi i pasurive natyrore nga shoqëritë private të huaja dhe shqiptare.

*Audienca:* të rinjtë në përgjithësi

*Qëllimi:* të nxjerrë në pah se çfarë po ndodh me natyrën shqiptare; efektet e saj në jetën e njerëzve dhe veprimet që duhen rekomanduar.

*Këndvështrimi:* ajo që po ndodh me natyrën është e padrejtë.

*Imazhet ilustruese:* shkatërrimi i natyrës, humbja e bimëve, pemëve, insekteve dhe kafshëve, humbja e vlerave kulturore në zona të ndryshme.

*Qëndrimet e shfrytëzuesve,* p.sh.: shkatërrojnë për përfitime.

*Konkluzioni:* Pezullimi i shfrytëzimit pa kriter nga kompanitë që janë të përfshira në një veprimtari të tillë.

Të krijuarit/shkruarit argumentues dhe bindës janë sfida për shumë nxënës. Të shkruarit duhet të inkurajohet si një mënyrë e të menduarit rreth çështjeve të eksploruara. Lloji i zhanrit duhet të shihet si një mënyrë që ndihmon për të përdorur forma koherente dhe efektive në të menduarit dhe të shkruarit e tyre. Janë të pashmangshme “tensionet” e nxënësve, ndaj mësuesit duhet të jenë të ndjeshëm në trajtimin e tyre, veçanërisht në komentimin e tyre vlerësues. Shkrimi në vazhdimësi (apo versionet e

shkurtuara të formave) është mënyra më e mirë për t'u aftësuar. Njohja dhe familjarizimi me format e të shkruarit do t'i ndihmojë nxënësit të pasqyrojnë dhe të analizojnë pikat e forta dhe mospërputhjet në shkrimet e tyre.

## **GJUHA E TREGIMIT**

### *Qasjet në mësimdhënien e tregimit*

Nxënësit e dinë që në një tregim veprimi ka një fillim, një zhvillim dhe një mbyllje.

Kjonjohuri mund të shfrytëzohet në leximin e çdo vepre narrative. Por, nga ana tjetër, nuk mund të themi se nxënësit janë të aftë të formojnë vetë një tregim në mënyrë koherente. Qasja e mëposhtme përqendrohet në ndërtimin e kuptimit/domethënies.

### *Shembull:*

Lexoni tekstin “Rrugë me baltë”<sup>4</sup>

Dy murgj, Tanzani dhe Ekido, u kthyen nga udhëtimi i gjatë për në manastir.

Ata kishin ecur nëpër një rrugë me baltë. Gjatë rrugëtimit të tyre, në anë të udhës, murgjit panë një grua të bukur. Zonja ishte e shqetësuar dhe nuk po kalonte rrugën, pasi mendonte se manteli i saj i gjatë mund të bëhej pis. Murgu Tanzan e pyeti:

-Mund t'jundihmoj përtë kaluar? Gruaja pranoi me kënaqësi. Tanzani e mori në krahë dhe kaloi rrugën. Më pas murgjit vazhduan udhëtimin e tyre. Kur po i afroreshin manastirit, Ekido i thotë Tanzanit: -Ju e dini se rregullat tona nuk e lejojnë që të shikosh një grua, ndërsa ju e morët atë në krah. Sigurisht, është detyra ime t'ju raportoj te abati. Dhe këtë do ta besojnë të gjithë, se ende ndihet aroma e parfumit të saj. Tanzani iu përgjigj: - Ekido, shoku im, unë e lashë gruan prapa meje, në anë të rrugës dhe kuptohet se aroma e parfumit të saj tregon se ajo është ende me ty.

---

Është marrë ky tekst i shkurtër vetëm për ilustrim.

### *Të kuptuarit*

Fillimisht e lexojmë, e shijojmë dhe e diskutojmë si përvojë letrare imagjinative.

Disa qasje të sugjeruara:

- Çfarë imazhi krijon tregimi?
- Çfarë përshtypje lë secili nga murgjit?
- Cili nga ata është shoqëruar më i mirë?
- Çfarë konfliktesh dhe pyetjesh ngrihen në këtë trillim?
- Është Ekido vërtet në një të drejtë morale?
- Cili do të jetë konteksti bashkëkohor për një ngjarje të tillë?
- ... etj.

### *Aftësia*

Identifikimi i strukturës

Elementet e tregimit

Identifikimi i zhanrit

### *Metodologjia*

- Kërkojuni nxënësve të ndajnë tekstin në tri skena të veçanta.
- Diskutoni mbi bazën e përzgjedhjes.
- Tregoni që skenat janë të lidhura nga mjete strukturore që i përkasin përshkrimit të një udhëtimi. Kjo i jep tregimit formën e tij.
- Skiconi elementet e tregimit, p.sh.: veprimet, karakteret, vendndodhjen, kohën.
- Gjejini ato në tregim. Vendosni cila është më e rëndësishme. Kjo jua bën të qartë nxënësve se tregimi e krijon kuptimin e tij kryesisht përmes veprimit. Diskutoni qëllimin e tregimit:
- Përse është shkruar në këtë formë: për të dhënë një mesazh moral?.

### *Të krijuarit*

#### *Aktivitet 1.*

Nxënësve mund t'u jepet detyrë të shkruajnë një tregim



duke përdorur disa elemente të formës së trillimit. Kështu ata mund të shkruajnë një tregim që e merr thelbin nga një udhëtim apo të shkruajnë një histori me një mesazh të qartë moral. (Këto tregime mund të bazohen në përvojën e tyre apo të jenë imagjinare) Mësuesi duhet të vendosë me nxënësit se cilat aspekte të tekstit të dhënë mund të jenë me vlerë për t'u imituar. Nuk pritet që të imitohen të gjitha aspektet e modelit në një detyrë me shkrim.

Shembulli i mëposhtëm është rezultat i qasjes së përkthuar më lart. Ky mund të jetë i dobishëm për t'u diskutuar me nxënësit si rast. *...Dy zezakë, Thomasi dhe Xhejmsi, takuan në një urë një njeri të bardhë. Ura ishte aq e ngushtë, sa kishte vend për të kaluar vetëm një person. Njeriu i bardhë kishte filluar të kalonte urën, kur Xhejmsi nxitoi dhe e arriti atë. Kjo e detyroi kalimtarin të kthehej mbrapa. Thomasi, zezaku tjetër, nuk veprroi si miku i tij. Ai priti dhe e ftoi njeriun e bardhë të kalonte. Ky e falenderoi Thomasin për mirësjelljen e tij. Kur Thomasi erdhi, Xhejmsi i inatosur tha: "Ti ke tradhtuar racën tënde duke iu nënshtruar atij njeriu! E di mirë ti si na kanë trajtuar ata në sheku!. Pse nuk e përdor lirinë tënde kundër tij?!"*

*Thomasi u përgjigj: "Unë gëzoj lirinë time duke bërë një zgjedhje, ndërsa ti nuk bën asnjë zgjedhje".*

### *Aktiviteti 2.*

Ideja e një udhëtimi gjendet në shumë tregime. Mund të zgjidhet zhvillimi i një linje në lidhje me personazhet, ngjarjet apo mjediset dhe t'u kërkohet nxënësve që ta përshtatin në përputhje me rrethanat e trillimit.

Për shembull ata mund:

- të zgjasin dialogun apo veprimin;
- të shtojnë ose përforcojnë karakteret/personazhet;
- të ndryshojnë këndvështrimin narrativ;
- të krijojnë vendndodhjen.

Kështu, nxënësit do të shohin se, duke futur këto ndryshime, po zhvillohet zhanri i tregimit të shkurtër, prandaj ka mundësi për të bërë interpretime. Në këtë pikë është e dobishme për mësuesin që të sugjerojë dhe të demonstrojë disa modele. Më poshtë është një sugjerim për zhvillimin e ngjarjes, kryesisht përgjatë linjave të veprimit dhe personazheve. *Ekido raportoï për Tanzanin te abati. Abati që nuk e pëlqen Tanzanin, e largon atë nga manastiri për një vit. Gjatë atij viti, Tanzanin i ndodhin tri ngjarje, të cilat vendosnin për të ardhmen e tij. . .* Nxënësit mund të ftohen për të zgjedhur tri ngjarjet dhe të tregojnë efektin e tyre te Tanzani. Mësuesi mund të sugjerojë disa mundësi:

1. *Tanzani mund të përballë me përvoja që lëkundin besimin e tij te qeniet njerëzore.*
2. *Ai mund të takohet me përvojat që ripërtërijnë besimin e tij dhe i japin frymëzim dhe forcë..*
3. *Ai mund të takohet përsëri me një vajzë të bukur. Çdo të ndodh me të? Së fundi, Tanzani mund të kthehet në manastir dhe të takohet me*

*Ekidon e abatin... Si do të përfundojë historia? ... Kërkoni sugjerime.* Ky lloj ushtrimi ka rëndësi, pasi demonstroi se të gjitha tregimet janë ndërtuar duke u bazuar në modele me qëllime të qarta ose të nënkuptuara të autorit, për të patur një ndikim, për të dhënë një pamje të veçantë të realitetit apo për të zbuluar eksperiencën.

Ndryshimi i ndonjë aspekti të tregimit, si: karakteret/personazhet, skena, struktura ose përfundimi mund të ndryshojë kuptimin e tregimit.

### *Zhvillimi i aftësive përshkruese*

Në këtë drejtim, shkrimi i nxënësve mund të ketë mangësi në dhënien e detajeve (specifike, konkretizuese, interpretuese). Kjo mund

të ndodhë në rastin e përcaktimit të ambientit/vendit ku zhvillohet ngjarja,po edhe në rastin e karaktereve. Detajet e dhëna mund të jenë të pamjaftueshme për lexuesin për të përfytyrojë personazhin apo vendin. Pra, veprimi i tregimit zhvillohet në një mjedis të paqartë dhe me personazhe të parealizuara. Si rezultat, lexuesi mërzhitet shpejt sepse ka pak mundësi për të ushqyer imagjinatën e tij. Detajet përshkruese, të përdorura me vend, janë element përbërës i tregimit të suksesshëm për ata që japin thelbin dhe individualitetin e personazheve të krijuara.

*Disa qasje për të zhvilluar aftësitë përshkruese.* Pjesa më e madhe e kësaj pune mund të bëhet me sukses në kuadrin e leximit të teksteve letrare, të cilat janë zgjedhur për studim. Aspekte të këtyre teksteve mund të përdoren për të mësuar teknika të përshtatshme. Të përshkruarit varet nga konteksti.

#### *Shembull 1.*

Policia ka njoftuar për zhdukjen e një vajze. Ajo quhet A.B, është 16vjeçe, 150 cm e gjatë, e hollë, me flokët të gjatë, ngjyrë kafe. Vajza ka dy palë vathë në çdo vesh dhe një flutur tatuazh në parakrah. Është larguar nga shtëpia që më 9 shkurt të vitit .... Kur është parë për herë të fundit, ka qenë e veshur me një këmishë dhe xhinse të zeza.

#### *Lloji: Njoftim në gazetë, në rubrikën “Njerëz të humbur”*

Ky përshkrim është faktik. Ai sjell pamje ku përshkruhet një person nga ana fizike dhe veshja. Edhe pse nuk ka përpjekje nga ana e gazetarit për të krijuar personin A.B, konkluzionet e lexuesit do të jenë subjektive dhe të përgjithshme.

*Shembull 2.* Mësuesi mund të përdorë një fragment ku të përshkruhet një personazh i krijuar nga shkrimtari.

*LLoji: Portreti i një personazhi imagjinar.*

Ky është një përshkrim që jep shumë më tepër informacion. Detajet e dhëna sugjerojnë diçka rreth personit, zakonet e tij, vlerat dhe pamjen. Përveç kësaj, përshkrimi nxit një reagim emocional në imagjinatën e lexuesit

*Të krijuarit*

Nxënësve mund t'u jepet detyra e mëposhtme:

1. Zgjidhni një personazh të njohur nga jeta publike.
  - a. Përshkruajeni atë në një paragraf të shkurtër faktik dhe interpretues.
  - b. Përfshini të paktën tri detaje.
2. Merrni personazhet e pjesës “Rrugë me baltë” dhe përshkruajini.

## **AUTOBIOGRAFIA**

“Çdo njeri ka një histori të vetën për të treguar” Brenda llojit të teksteve tregimtare ka dallime mes një rrëfimi të bukur, imagjinar, p.sh.: përralla, tregime, novela të shkurtra dhe tregimit joimagjinar, p.sh.: autobiografi, biografi dhe shkrimet e udhëtimeve. Struktura e shkrimeve të udhëtimit është e bazuar në përvoja reale në hapësirë dhe në kohë. Në autobiografi, tregimi do të priret të ndjekë rendin kronologjik të ngjarjeve në jetën e një personi, ndërsa në shkrimin e udhëtimeve është udhëtimi nga një vend në tjetrin, ai që jep formën e tregimit. Kjo nuk do të thotë se autorët e tregimeve autobiografikë dhe të udhëtimit janë “të izoluar” nga koha dhe vendi. Ata janë të lirë të zgjedhin dhe të refuzojnë ngjarje për të krijuar ato përvoja që dëshirojnë të paraqesin në tregimet e tyre. Ashtu si në të gjitha format narrative, domethëniet në tekst janë produkt i përzgjedhjes së ngjarjeve dhe të detajeve nga autori.

*Aftësia*

Njohja e detajeve të rëndësishme

### *Metodologjia*

Kërkojuni nxënësve:

- të zgjedhin fakte dhe të dhëna fizike nga personazhi X.Y në një tregim të dhënë dhe t'i paraqesin ato sipas modelit të njoftimit “Njerëz të humbur”. Shikoni efektin që bëjnë.
- të zgjedhin disa detaje që ata i konsiderojnë të rëndësishme për krijimin e emocioneve.

Diskutoni rreth ndikimit të tyre.

- të shkruajnë një përmbledhje të shkurtër në të cilën nxënësit përshtypjen e tyre për këtë njeri. Nxënësit mund të marrin parasysh edhe qëndrimin e autorit për atë personazh.

**Autobiografia** është një nga mënyrat më të dobishme, me të cilën nxënësit mund të mësojnë të shkruajnë me sukses tregimin dhe të zbulojnë rëndësinë e ngjarjeve personale, ndërsa janë duke i punuar ato. Nxënësve mund t'u jepet detyrë të shkruajnë diçka nga jeta e tyre. Kjo do të bëjë që edhe ato përvoja të tyre që i kanë konsideruar si të parëndësishme, tashmë t'i shohin me një sy dhe vlerësim tjetër. Pikërisht ky lloj të shkruarit i ndihmon për ta zbuluar këtë gjendje.

### *Të kuptuarit*

Fillimisht, duhet të shqyrtohen disa shembuj të shkurtër të të shkruarit autobiografik për të zbuluar se si shkrimtarët krijojnë tekstet e tyre. Në analizën e këtyre lloj tekstesh mund të bëhen pyetje të tilla, si:

Ç'ngjarje, personazhe, vende dhe objekte janë të pranishme?

2. Çfarë është lënë jashtë?

3. Pse këto ngjarje, personazhe, vende dhe objekte dhe jo të tjera?

Duke patur në mendje pyetje të tilla mund të lexoni shembuj të ndryshëm të shkrimit autobiografik.

### *Analiza e zhanrit/gjinisë*

Duke parë versione të ndryshme të shkrimeve autobiografike, mund të vërejmë disa karakteristika:

- Autorët shkruajnë më së shumti përvojat e tyre personale.
- Renditja e ngjarjeve mbetet përgjithësisht besnike e kronologjisë së jetës së tyre.
- Ata zgjedhin ngjarje që kanë një ngarkesë emocionale për ta dhe kanë lënë gjurmë në kujtesën e tyre. Ngjarja përshkruhet dhe pastaj bëhet një koment mbi të.
- Ata sjellin ndërmend ngjarjet dhe i përshkruajnë ato në mënyrë të tillë që të rikrijojnë vlera më të mira nga përvoja e fëmijërisë

Secila nga këto *copëza jete* të krijon ndjesinë e një bote të veçantë, të përjetuara nga një fëmijë. Autori përpiqet të komunikojë një radhë kuptimesh dhe interpretimesh të përvojave të tij si fëmijë. Kërkojuni nxënësve që të shkruajnë përvoja nga jeta e tyre. Në këtë mënyrë ata do të shikojnë se në ngjarjet e zakonshëm të jetës ka përvoja në të cilat zbulohen vlera që mund të shkruhen për t'u lexuar edhe nga të tjerët.

### *Të krijuarit*

Sugjerime për të ndihmuar nxënësit kur bëjnë një shkrim autobiografik:

1. të shkruajnë tri objekte që mbajnë mend nga fëmijëria. Është mirë që mësuesi të japë shembuj nga fëmijëria e tij sa për ilustrim; p.sh.: një foto a pikturë, një bufë kuzhine a një biçikletë me tri rrota, një sobë e vjetër, një kukull, një pemë etj.
2. të zgjedhin një nga objektet e fëmijërisë së tyre dhe të shkruajnë një paragraf përshkrues rreth tij. Ata inkurajohen që të përdorin ndjesi të shumta në përshkrimin e objektit të zgjedhur.
3. të zhvillojnë më tej paragrafin e tyre ose duke komentuar objektin që kanë përshkruar, ose duke treguar ndjenjat që ka shkaktuar objekti në të

kaluarën, po edhe tani.

4. më pas nxënësit mund të përshkruajnë një objekt tjetër.
5. në fund nxënësve mund t'u kërkohet të lidhin të dy paragrafët përshkrues së bashku, duke ndërhyrë me një paragraf shpjegues që ndihmon për t'i vënë paragrafët në një kontekst më të gjerë. Një metodologji e ngjashme mund të jetë e dobishme edhe për autobiografinë duke ndryshuar fokusin nga objektet te personazhet, vendet, ngjarjet.

## **PËRDORIMI ESTETIK I GJUHËS**

Kjo kategori e gjuhës thekson se gjuha mund të jetë një medium artistik. Fjalët, ashtu singjyrat dhe modelet në art apo tingulli në muzikë, mund të përdoren për të krijuar produkte, qëllimi primar i të cilave është që të japin kënaqësi estetike, të pasurojnë përftyrimin, perceptimin, ndjenjat.

- Tekstet mund të trajtohen si ngjarje që zhvillohen, interpretohen dhe transformohen në mënyra të ndryshme. Metodologjitë aktive i angazhojnë nxënësit me përvojën e tekstit si art.

Është e rëndësishme që nxënësit ta shohin letërsinë si një art, që duhet ta përjetojnë, si një përvojë shprehëse dhe të pëlqyeshme. Në vijim janë disa sugjerime për qasjet metodologjike për mësimin e letërsisë që theksojnë ekspresive dhe imagjinare.

### ***1. Trillimi***

1. Mësuesi lexon paraprakisht tekstet dhe përcakton përafërsisht kohën që duhet për të punuar me tekstin. Kjo, sigurisht, do të ndryshojë shumë në varësi të tekstit (gjatësia e tij dhe vështirësia) dhe aftësisë së nxënësve. Mësuesi duhet të vendosë edhe mbi numrin e leximeve që do të bëhen në klasë dhe shumën e leximeve individuale që nxënësi do të bëjë për detyrat e shtëpisë dhe në klasë. Në periudhën 3-vjeçare

të gjimnazit do të lexohen dhe punohen hollësisht 10 vepra të plota. Këto dhjetë lexime do të përqendrohen në skenat dhe momentet më të rëndësishme të veprës, p.sh.: momentet e konfliktit, zgjidhjes, zbulimit, zhvillimit, ndryshimet e karakterit, ambienti i skenës, tematika dhe komentet autoriale. Këto lexime duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të rrisin interesin e nxënësve për të lexuar më tej në mënyrë individuale.

2. Leximi individual, gjithmonë, duhet të jepet menjëqëllim të caktuar në mënyrë që nxënësi ta ndiejë përse po e lexon; p.sh.: Shkruani dy momentet më të rëndësishme të këtij fragmenti. Si duket personazhi në një vështrim të ri? Si u ndjetë për sjelljen e heroit apo të dikujt tjetër në këtë fragment etj.?

3. Nxënësit duhet të mbajnë shënime në *ditarin*<sup>5</sup> e tyre gjatë çdo leximi individual për t'iu përgjigjur kërkesave dhe qëllimit të leximit. Në këtë mënyrë ata gradualisht do të sigurojnë një numër të konsiderueshëm përgjigjesh për të kuptuarit e tekstit, të cilat vijnë duke u rritur cilësisht dhe zhvillojnë kapacitetin e nxënësve për të lexuarit estetik, d.m.th të jenë të aftë të lexojnë dhe të shfrytëzojnë njohuritë e tyre kur përgjigjen për çështje të ndryshme. Natyra e komenteve në *ditarin personal* nuk ka për qëllim të jetë akademik dhe eseist në qasje. (Komentet nuk duhet të jenë një përmbledhje e rëndomtë e subjekteve) Një qëndrim i tillë nuk është i përjashtuar si një mënyrë përgjigjeje, por fillimisht duhet që komentet të jenë të natyrës joformale.

Përgjithësisht, në fillim, përgjigjet për një roman mund të jenë, p.sh.: a) Fillimi i këtij fragmenti nuk më jep ndonjë ndjesi të veçantë dhe më krijon raporte të ftohta me pjesën. Historia lëviz shumë ngadalë dhe për një kohë, përshkrimet e gjata të figurës së gruas në të vërtetë më largojnë nga ngjarja. Pres që të jetë histori e zakonshme romantike. . . Pyes veten pse e lexoj këtë libër? Mos është më mirë ta shoh në video?

---

Këtu nuk bëhet fjalë për ditarin personal të nxënësit, por për shënimet ditore që mban nxënësi kur punon detyra me qëllime të caktuara. Në këtë rast kemi të bëjmë me ditarin e nxënësit.



ose:

b) U ndjeva keq për gruan. Ajo më duket e bllokuar në një marrëdhënie të vështirë.

Unë shpresoj se ajo do t'ia dal. Kjo situatë më kujtoi një film që e pashë kohët e fundit. ..etj.

4. Pasi bëhet leximi, i parë nga perspektiva të ndryshme siç thamë më lart, mund të bëhet rileximi i pjesshëm për të thelluar të kuptuarit e nxënësve. Këto perspektiva mund të jenë ose të zakonshme, si: personazhi, temat, konfliktet dhe stili, ose mund të jenë përpjekje për t'iu përgjigjur pyetjeve kritike, të tilla si:

- pse u shkrua ky roman?
  - çfarë përpiqet të thotë autori?
  - pse është shkruar në këtë mënyrë?
  - çfarë është lënë pas dore në këtë roman? A ka ndonjë aspekt të realitetit që ju do të donit ta shihnit më tepër në këtë roman?
  - sugjeroni mbyllje alternative për romanin. Mendoni se çfarë ndikimi do të kenë këto mbyllje në domethënien e përgjithshme të romanit.
- Tani rishqyrtojmë mbylljen e dhënë nga autori dhe domethënien e saj.
- Ç'tregon kjo për qëndrimin kulturor, politik dhe social të autorit?
  - Ç'pyetje të tjera mund t'i bëni autorit?
  - A ka ndonjë pjesë të romanit që dëshironi të polemizoni?
  - Çimazhe, njohuri, ide, pyetje kanë qenë parësore për ju?
  - Sa ndikon përvoja e leximit të këtij romani në të kuptuarit e letërsisë dhe të jetës tuaj?

## **2. Poezia**

### *Performanca dhe interpretimi*

Poezia si përvojë e tingullit, ritmit dhe fjalës duhet të eksperimentohet në mënyrë të përsëritur. Poezia gjithmonë duhet të prezantohet me gojë nga mësuesi. Që një pjesë e nxënësve të kuptojnë

dhe të vlerësojnë ndikimin dhe anën artistike të një vjershe/poeme, duhet të bëhet recitimi interpretativ i saj. Ky duhet të mendohet si një pjesë normale në procesin e leximit të poemës/poezisë në mënyrë që nxënësi ta ndiejë plotësisht atë. Akti i artikulimit rrit mprehtësinë dhe nivelin e përgjigjeve, gjë që leximi në heshtje nuk mund ta bëjë.

Qasjet e mundshme:

- Mësuesi lexon poemën/poezinë.....
- Klasa ndahet në grupe (4-5). Çdo grup përgatit leximin e poemës/poezisë nëse teksti është i shkurtër ose leximin e një fragmenti nëse teksti është më i gjatë.
- Pas leximit, diskutohet kuptimi i pjesëve të grupeve të ndryshme. Çështje për diskutim mund të jenë: fjalët që theksohen më shumë, toni i realizuar, humori i krijuar etj.
- Pas diskutimit mbi interpretimet e mundshme, grupet i riformojnë dhe i rishikojnë interpretimet e tyre. Nëse është e nevojshme edhe mund t'i paraqesin pjesët e tyre në klasë.

Kjo qasje nuk është as një ushtrim i artit të oratorisë, as një përpjekje për të arritur një nivel të pranueshëm të “performancës teatrale”. Ai është thjesht një qëndrim metodologjik, i cili përpiket të tregojë që poezia ka ndjeshmëri më të fortë në përvojën e nxënësve. Ky është një mjet për të njohur nxënësit me faktin se leximi i poezisë është i ndryshëm nga leximet e tjera që ata bëjnë në shkollë.

#### *Disa sugjerime metodologjike*

Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm se poezia përdor modele gramatikore dhe sintaksore për të ndërtuar kuptime, ndërsa për t'i dhënë forcë dhe veprim të shpejtë përdor një sërë mjetesh dhe teknikash të tjera, p.sh.: ritëm, ton, shëmbëlltyrë, kontrast, tinguj dhe sugjerim. Të gjitha këto

janë themelore për mënyrën sesi punon çdo poezi. Ato krijojnë modele në mënyra të ndryshme, të cilat duhet të njihet me qëllim që efekti i poezisë të realizohet plotësisht. Me fjalë të tjera, në poezi janë një sërë modelesh, të cilat e ndryshojnë atë nga një medium komunikimi te një medium estetik / artistik. Nxënësve duhet t'u bëhet e qartë se mënyra më e mirë për t'iu afruar poezisë është trajtimi i fjalëve në të gjitha dimensionet e tyre. Poezia punon në një mënyrë të ndjeshme. Ajo nuk kërkon vetëm të komunikojë ide e të japë një mesazh. Poezia krijon një seri imazhesh / tablosh / skenash të fuqishme në imagjinatën tonë, të cila ndërveprojnë në mënyra të ndryshme dhe krijojnë ndjenjat dhe përvojat. Të lexosh poezi do të thotë edhe t'i interpretosh këto skena dhe përvoja jo në nivelin riprodhues, pra të thënë fjalë për fjalë, por në nivelin e kuptimit të mëtejshëm. Shpesh nxënësit priren të jenë në nivel riprodhues. Çlirimi nga të thënit fjalë për fjalë arrihet duke zbatuar një metodologji që ka si parim bazë të saj praktikën e leximit disa herë të një vjershe.

#### *A. Reflektimi mbi imazhet*

1. Përmbliidhni imazhet kryesore të poemës/poezisë së dhënë.
2. Çfarë sugjerojnë në aspektin e ndjenjave ?
3. A ndërtojnë imazhet ndonjë model? A kundërshtojnë apo plotësojnë ata njëri-tjetrën?
4. Del ndonjë kuptim nga modeli i krijuar?

#### *B. Bërja e pyetjeve*

1. Shkruani disa pyetje që ngrihen nga poema/poezia e dhënë, të cilave ju nuk ua dini përgjigjen.
2. A janë përgjigjet e tyre në poemë? Rilexo poemën duke pasur në mendje pyetjet.
3. Nëse jo, arsyetoni pse në poemë ngrihen këto pyetje që janë disi të veçanta për ju.

*C. Vënia në dukje e fjalëve / shprehjeve*

1. Shënoni disa fjalë dhe fraza nga poema/poezia, të cilat ju tërheqin.
2. Rilexoni poemën (poezinë) për të gjetur fjalë të tjera, të cilat mund të lidhen me zgjedhjet tuaja fillestare.
3. Kur të keni krijuar disa grupe fjalësh, arsyetoni mbi pyetje të tilla si:
  - a formojnë këto grupe fjalësh ndonjë model?
  - a tregon /krijon ky model ndonjë atmosferë apo botë shpirtërore?
  - cila është marrëdhënia midis grupeve të ndryshme? A ka ndonjë konflikt / dallim mes tyre?

Ja disa modele që mund t'i gjeni në poema të ndryshme:

- modele të fjalëve të ngjyrave: e bardhë, jeshile, e purpurt, e verdhë, e kuqe
- modele të mohimit: askush, asgjë, ata nuk janë ...,
- modele të fjalëve të “çuditshme” e të huaja: p.sh. çapaçul, gërshetëz etj
- figurat e kontrastit; nata e zezë, shpirti i bardhë; me trup të madh dhe sy të vegjël etj.

Të shkruarit konsiderohet si integrimi i të lexuarit dhe të shkruarit. Nxënësve u jepet një model dhe u kërkohet ta imitojnë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Si mund të bëhet kjo?

Një nga sugjerimet e studiuesve është të përqendruarit te ideja e poezisë, e pranishme në çdo krijim. Kjo do të thotë se çdo krijim ka një një model të shprehjes së ndjenjave, të mishëruara në një formë gjuhësore.

Fillimisht, nxënësit duhet të jenë të përfshirë në poemë/poezi në mënyrat e përshkruara më lart dhe më pas, të ndihmuar nga mësuesi, ata mund të identifikojnë një ndjenjë a formë gjuhësore për ta imituar.

### **3. Drama**

Metodologjia tradicionale, të lexuarit rresht më rresht të një pjese dramatike, ka filluar të zbehet disi përballë mundësive të përdorimit

të kasetave dhe të burimeve video. Pika e dobët në këto raste është se nxënësi luan rolin pasiv të një anëtari të audiencës - pa dyshim një rol që është thelbësor për të mësuarit. Për këtë duhet të krijohen mundësi që nxënësit të bëjnë paraqitje interpretuese të pjesëve ose të gjithë tekstit dramatik. Në këtë rast qëllimi nuk është për të realizuar plotësisht një produkt, por për të rritur më shumë mprehtësinë dhe njohuritë e nxënësit. Këto objektiva mund të arrihet në mënyra të ndryshme. Shmangni praktikën e leximit nga nxënës të ndryshëm të pjesëve të gjata të tekstit, kur ata janë të papërgatitur, pasi nuk bëhet lexim i kuptimshëm dhe pjesa tjetër e klasës mund të mërzitet. Metodologjia e përdorur për interpretimin e poezisë është mjaft efektive edhe për pjesët dramatike, nëse skena për interpretim është paracaktuar nga mësuesi

### *Perspektiva semiotike*

Kjo përfshin përdorimin e shenjave dhe simboleve për të krijuar kuptime dhe perspektiva interpretuese.

Kjo është një fushë me mundësi të shumta për zhvillimin e imagjinatës së nxënësve në mënyrë tre-dimensionale. Në rastin e mësimit të dramës dhe të filmit është e një rëndësie të veçantë. Nxënësit duhet të përqendrohen te sistemi i shenjave që përdoren në dramë, p.sh.: ambienti, kostume, objektet e skenës, tinguj etj.

Ata mund të ndërmarrin një sërë aktivitete, p.sh.:

- cilat objekte janë të përshtatshme në një skenë?
- çfarë veshje ose objekte janë të lidhura me personazhin ?
- cili do të jetë imazhi i tyre në një poster?
- cilat ngjyra dhe pamje lidhen me secilin personazh?

### **Qasjet në studimin krahasues të teksteve**

Megjithëse tekstet letrare janë produkte estetike, ato mund të trajtohen nga një sërë këndvështrimesh të tjera, p.sh.: kulturore, historike, sociale,

të cilat mund të pasurojnë të kuptuarit e rolit dhe rëndësisë së letërsisë. Studimi i teksteve nga këto perspektiva i fton nxënësit për të bashkëvepruar mebotë të ndryshme imagjinare, për të bërë dallime dhe vlerësime. Studime të tilla rrisin shkallën e ndërgjegjësimit të nxënësve.

### **Mënyrat e krahasimit**

Mënyra krahasimi për një nivel të lartë janë:

- një temë ose çështje,
- një periudhë historike/letrare,
- një zhanër letrar,
- kontekst kulturor,
- vizioni i përgjithshëm dhe opiniononi.

Mënyra krahasimi për një nivel të zakonshëm janë:

- heroi/heroina,
- marrëdhëniet,
- ambienti sociale,
- ndryshimi dhe zhvillimi,
- tema specifike: dashuria, paragjykimi, dhuna,
- aspektet e tregimit: konflikte, pika kulmore, përfundimi.

Ndërsa disa nga këto mënyra janë vetëshpjeguese, të tjerat kanë nevojë për disa sqarime:

#### *1. Tema/çështje*

Krahasimi i teksteve mbi një temë të caktuar. Këto duhet të jenë tema kryesore dhe të njohura të teksteve të zgjedhura për studim; p.sh.:

- varfëria
- dashuria,
- lufta / dhuna
- figura e gruas etj.

#### *2. Periudha historike / letrare*

Zgjidhni tekste nga periudha të ndryshme dhe krahasojini ato si produkte të periudhave që u përkasin. Ky krahasim përqendrohet te mënyra në të cilën idetë letrare dhe filozofike mbizotëruese të periudhës janë të shprehura në tekst. Nxënësit duhet të arsyetojnë sesi e shohin autorët e periudhave të ndryshme artin dhe rolin e tyre në shoqëri; p.sh.:

Në një krijim romantik autori e idealizon realitetin në përshtatje me predispozitat e tij shpirtërore, ndërsa një autor realist e tregon deri në detaje realitetin ashtu si është në të vërtetë, duke vënë gishtin në plagët e këtij realiteti. Kjo do të thotë se çdo kohë lë gjurmë në veprën e shkrimtarit dhe e organizon, madje, veprën e tij si produkt të periudhës që i përket.

Krijimtaria e Asdrenit në periudha të ndryshme u pasqyrua me ndryshimin e pozicionit romantik në pozicionin e realistit e të kritikuesit. Pra, brenda veprës së një shkrimtari koha lë “vulën” e vet. Madje, edhe brenda të njëjtës vepër, të shkruar në periudha të ndryshme, koha lë gjurmët e saj dhe s’ka si të ndodhë ndryshe. Poezia “Poradeci” e Lasgush Poradecit vjen me dy variante, të cilat poeti i ruajti të vlefshme si variante të njëra-tjetrës, më 1922-shin dhe 1929-n.

Varianti i shkruar më 1922-in është një krijim i ëmbël djaloshar, ku nata shqiptare të jep një ndjesi gati magjike, ndërsa varianti i 1929-s vjen më i errët, të lë në shpirt pezmatimin e pamundësisë për t’u shprehur, ngjyrat e natës që shkojnë deri në shkrumb. Duket se bashkë me të janë djegur edhe shpresat e heroit lirik. Sigurisht, kriza e madhe e viteve 1929, e cila kishte përfshirë gjithë botën e që në Shqipërinë e varfër ndihej më shumë, ka pjesën e saj, por edhe ndryshimi i sistemit politik për Lasgushin republikan ishte i rëndë. E gjitha kjo ndikon në atmosferën pezmatuese të poezisë.

### **C. Modele të orëve mësimore**

Më poshtë po paraqesim modele, që mund të ndihmojnë mësuesit për të realizuar objektiva të ndryshëm të programit mësimor.

#### *Model*

#### **“Leximi” i ndihmësve pamore**

Kjo orë mësimi zberthen disa nga objektivat e **të vështruarit**, duke i harmonizuar ato me objektivat për **të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të lexuarit**.

#### **Objektivat:**

Në fund të kësaj ore mësimi nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë elementet artistike më të rëndësishme të tablove duke interpretuar domethënien e tyre;
- të zbulojë detajet për të treguar mënyrën si harmonizohen me njëra-tjetrën në funksion të përmbajtjes;
- të zbulojë lidhjen ndërmjet diçiturës së tablove dhe përmbajtjes së tyre;
- të paraqesë në mënyrë të përmbledhur (me gojë) këndvështrimin e tij mbi përmbajtjen e tablosë;
- të krahasojë tablotë që u përkasin shkollave të ndryshme artistike, duke treguar me gojë mendimin e tij për veçoritë specifike të secilës;
- të shkruajë përfundimet nga vëzhgimi i tablove duke argumentuar.

#### **Materielet që do të përdoren:**

Tablo të fotografuara të Da Vincit, Rembrandtit, Van Gogut, Pikasos, Dalise, V. Mios dhe A. Buzës.

Video Projektor (nëse ka mundësi)



**Metoda:**

- Brainstorm-i
- Diskutimi
- Punë në grupe
- Diagrama e Venit

**Zhvillimi i mësimit**

**Veprimtari parapërgatitore:**

Klasa është ndarë në grupe (me 4-5 nxënës për grup) dhe nxënësit janë porositur që të gjejnë:

- a. Foto të tablove të piktorëve të caktuar;
- b. Të dhëna për jetën dhe veprën e tyre;
- c. Veçoritë kryesore të epokës dhe rrymës që u përkasin;
- d. Materiale ndihmëse nga literatura për zbërthimin e përmbajtjes, të detajeve kryesore dhe historikun e krijimit të tablove.

Ky informacion do të përgatitet me shkrim dhe do të ligjërohet me gojë, ndërkohë që pamjet vizive (ndihmësit pamorë) do të ndihmojnë për të qartësuar tekstin e ligjëruar nga nxënësit.

Mësuesi u kërkon nxënësve të paraqesin tablotë që kanë përzgjedhur, ndërsa secili prej tyre do të ligjërojë me gojë sipas detyrës që ka marrë në grup.

Pas referimit të çdo grupi, nxënësit e tjerë, (dëgjuesit, auditori) bëjnë komentet e tyre për tablonë dhe diskutojnë për interpretimet që dëgjuan nga shokët.

Mendimet më të spikatura shkruhen në tabelë.

Pas vëzhgimit dhe interpretimit të tablove, mësuesi u kërkon nxënësve të krahasojnë dy tablo të autorëve të ndryshëm dhe të tregojnë me shkrim dallimet dhe të përbashkëtat në efektet pamore. Për këtë mund të përdorin Diagramën e Venit.

Dëgjohen përgjigjet e nxënësve, ndërsa Diagrama e Venit paraqitet në tabelë nga një nxënës i grupit.

Në fund mësuesi bën vlerësimin e punës së nxënësve, duke marrë parasysh edhe vlerësimin që vetë ata bënë për njëri-tjetrin.

### **Praktikë e pavarur: (detyrë për në shtëpi)**

Bëni një ese ku të përshkruani sipas këndvështrimit tuaj tablonë që u pëlqen më shumë.

### Model

### **Si të punohet me një tekst poetik ?**

Tema: Elementet e një teksti të shkurtër poetik, vjershë.

### **Objektivat:**

Në fund orës së mësimit nxënësi do të jetë i aftë të:

- të përkufizojë vjershën si lloj i gjinisë së poezisë;
- të përkufizojë elementet (karakteristikat) e një poezie të shkurtër;
- të diskutojë një poezi të shkurtër ose këngë duke analizuar çdo element të saj;
- të shkruajë një kuiz rreth elementeve të poezisë së shkurtër.

### **Metoda:**

Brainstorm-i

Diskutimi

Punë në grupe

Kuiz

### **Aktivitete dhe procedura:**

Është e domosdoshme që në këtë rast të punohet me një poezi të shkurtër.

#### **Hapi I.**

- a. Kërkoni nga nxënësit të japin mendime dhe shembuj për atë që e mendojnë si poezi të shkurtër. (në këtë rast mund të përdoret punë në grupe i organizuar)
- b. Thojuni t'i mbështesin zgjedhjet e tyre me argumente që tregojnë se teksti që kanë përpara është një poezi e shkurtër.

#### **Hapi II**

- a. Me anë të një brainstorm-i, përcaktohen karakteristikat e vjershës: vargu, strofa, rima, etj.
- b. Kërkojuni nxënësve të bëjnë një përkufizim për vjershën, duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme.

#### **Hapi III**

- a. Më pas u thoni nxënësve të zbulojnë të veçantën e poezisë së shkurtër duke dëgjuar (lexuar) poezinë e marrë si model.
- b. Leximi i poezisë. U thoni nxënësve të tregojnë elemente a veçori që ata zbulojnë në këtë poezi, si: titulli, vargu, strofa, zëri poetik, lloji i poezisë etj.
- c. Përkufizoni ndonjë nga elementet e mësipërme, si p.sh.: vargu, strofa etj., të cilat janë elemente të një poezie të shkurtër.
- d. Klasa lexon dhe diskuton elementet e poezisë së shkurtër dhe përqendron vëmendjen te zbulimi i elementeve në vjershën e dhënë.

#### **Hapi IV**

- a. Punë me grupe: Thojuni nxënësve që do të bëjnë një kuiz për elementet e poezisë.( për 5 minuta). Paraprakisht, është mirë

që nxënësit t'u hedhin një sy shënimeve të tyre për elementet e poezisë. Kuizi do të jetë i hapur.

- b. Pas çdo përgjigjeje, nxënësit do të ilustrojnë elementin e gjetur me fragmente nga poezia.

Në fund, mësuesi bën vlerësimin e punës së nxënësve.

## **PËRGATITJA PËR PROVIMIN E MATURËS SHTETËRORE**

Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë është provim i detyruar i Maturës Shtetërore. Për këtë nxënës/i,-ja do t'i nënshtrohet një testimi, në përbërje të të cilit do të jenë konceptet, njohuritë dhe aftësitë e mësuara në gjithë vitet e shkollimit. Për përgatitjen e nxënësve janë planifikuar 16 orë mësimore, të cilat do të realizohen në muajin e fundit të vitit mësimor.

***Mësuesi është i detyruar t'i planifikojë këto orë vetëm për përgatitjen e provimit të Maturës Shtetërore.***

Përgatitja për provimin e Maturës Shtetërore nuk është një proces i “izoluuar” vetëm në orët mësimore të planifikuara për të, ajo është e lidhur me gjithë periudhën e shkollimit. Kjo kërkon që çdo mësues:

- a) të zbulojë dhe të evidentojë arritjet e nxënësve;
- b) të planifikojë mbi bazën e arritjeve të tyre;
- c) të ushtrojë nxënësit në teste model.

a) Periudha parapërgatitore për provimin e Maturës Shtetërore duhet konceptuar si një fazë përmbyllëse e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë për arsimin e mesëm. Për të qenë një periudhë efikase, duhet që mësuesi të jetë i vëmendshëm gjatë procesit mësimor për të evidentuar arritjet e nxënësve, mbi të cilat do të planifikojë punën një mujore. Jo gjithçka mund të realizohet gjatë kësaj periudhe, ndaj kjo kohë duhet konceptuar si një fazë sistemimi dhe përforcimi të njohurive.

Lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë, për mënyrën sesi është konceptuar, jep mundësi që në vijim të procesit mësimor të plotësohen

hap pas hapi mangësi dhe probleme të vërejtura. Kështu, nëse konstatohet se nxënësit kanë vështirësi/mangësi, p.sh.: në *zbulimin e nëntekstit në një tekst poetik*, mësues/i,-ja dhe nxënësit kanë hapësira për të punuar me këtë element në tekstet në vijim. Fakti që nxënës/i,-ja përballet dhe ushtrohet në tekste të ndryshme, të shkruara ose jo të shkruara dhe mediatike, e bën më të lehtë “transferimin” dhe përdorimin e koncepteve, njohurive, aftësive edhe në tekste të tjera.

b) Është e domosdoshme që mësuesit të përgatitin një miniplan konkret dhe të përputhur me nevojat e nxënësve për: a) **të kuptuarit** dhe b) **të krijuarit** e teksteve të ndryshme, si: teksti tregimtar, poetik, dramatik, shpjegues, përshkruar, argumentues/bindës, informativ, teksti eseistik, si dhe forma të produkteve mediatike.

**I. Për të kuptuarit** e teksteve të shkruara, vëmendja duhet të përqendrohet tek: a) zbulimi dhe interpretimi i kuptimit të fjalës (me origjinë të huaj ose jo, kuptimet e dyta dhe të figurshme, frazeologjitë etj.); b) njohja dhe përdorimi i strategjive të të lexuarit për qëllime të ndryshme, si: për të kuptuar tekstin, memorizuar informacionin dhe monitoruar procesin e të kuptuarit, për të bërë parashikime, për t’i rishikuar dhe verifikuar ato; c) parafrazimi dhe aftësitë organizuese për të përmbledhur informacionin pa ndryshuar idenë e autorit; d) zbulimi i teknikave që përdor autori për të mbështetur qëllimin e tij; e) zbulimi i karakteristikave të formës dhe të përmbajtjes së teksteve; f) analiza dhe interpretimi i gjuhës së përdorur në tekst; g) analiza e stilit të autorit; gj) zbulimi i nëntekstit; h) krahasimi i dy teksteve për të treguar të veçantat dhe të përbashkëtat; i) interpretimi i një vepre në drejtim të arritjes artistike e gjuhësore, zbulimi i qëndrimit të autorit; j) roli i fjalëve në krijimin e tonit dhe atmosferës së veprës; k) zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, hiperonimia/hiponimia, fjalëshpejtat, shprehjet frazeologjike etj.

Për **të kuptuarit** e formave të ndryshme mediatike, vëmendja

duhet të përqendrohet tek: a) zbulimi i veçorive të produkteve mediatike (reklamë, fotografi, pikturë, skulpturë); b) mënyra sesi fjalët dhe imazhet përcjellin një mesazh; c) analiza dhe vlerësimi i një produkti mediatik si vlerë e kulturës që e prodhon; d) krahasimi i produkteve të ndryshme mediatike, por që trajtojnë tema të njëjta; e) analiza dhe vlerësimi i teknikave pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar; f) zbulimi i nënkuptimeve që fshihen pas imazheve statike; g) analiza e një reklamimi pamor; gj) analiza e teknikave pamore (ngjyra, zmadhimi/zvogëlimi, këndvështrimi, përzgjedhja e detajeve) etj.

Formulimit i pyetjeve analitike, sintetizuese e vlerësuese, si dhe përgjigjja e tyre, është mjaft e rëndësishme në procesin e të kuptuarit të të gjitha llojeve të teksteve.

**II. Për të krijuarit**, vëmendja duhet të përqendrohet tek: a) hapat e domosdoshëm të procesit të të shkruarit (parashkrimi, skicimi/shestimi, rishikimi, shkrimi, dorëzimi); b) përdorimi i strategjive të larmishme e të domosdoshme në planifikimin e një shkrimi; c) njohja dhe përdorimi i elementeve të sistemit të vlerësimit.

Gjithashtu, nxënës/i,-ja duhet të përdorë të gjitha elementet e domosdoshme për të përfunduar një shkrim të realizuar për një temë, për një qëllim e audiencë të caktuar. Rëndësi ka: a) draftimi i një ideje; b) shkrimi i paragrafëve me një stil vetjak dhe duke zbatuar kriteret gramatikore e drejtshkrimore për një produkt cilësor; c) forma e shkrimit duke zbatuar kriteret e domosdoshme sipas llojit.

Sigurisht që këto janë pika orientuese, pasi mësuesi planifikon mbi bazën e të dhënave të nxjerra, specifike për klasën.

d) Të ushtruarit në teste model, të ngjashme me formatin e provimit të Maturës Shtetërore, është i domosdoshëm, përpos të tjerave, edhe për të familjarizuar nxënësit me këtë format. Është mirë që nxënësit të punojnë të paktën një format testi të plotë, ku të përfshihen, veç pjesës së përmbajtjes, edhe rubrikat teknike që duhet të plotësojë nxënësi.

Programet orientuese të provimit të Maturës Shtetërore do të jenë një material më i hollësishëm për këtë problem.

### **3.VLERËSIMI I NXËNËSIT**

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi, dhe bashkëpunimi me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

#### **Kritere specifike për vlerësimin në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë**

Mësues/i,-ja mund ta vlerësojë nxënësin për aftësitë e të folurit dhe të të shkruarit për një larmishmëri audiencash dhe qëllimesh nëpërmjet disa mënyrash, si:

Ditari mësimor i nxënës/it,-es; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të qartësojë mendimet e të përgatitet për diskutimin në klasë, të

zbatojë efektivisht elemente të procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë përdorimin efektiv të gjuhës, si dhe qëndrimet e nxënësve.

Diskutimi mbi një film/dokumentar; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike e gojore të nxënësit, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.

Prezantimi me gojë; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të lexojë në mënyrë efektive dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë sesi ai sintetizon materialin e një teksti.

Shkrimi i esesë përshkruese; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të qartësojë mendimet e të përdorë efektivisht elementet e procesit të shkrimit dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij shkruese.

Për vlerësimin e aftësive për të lexuar, për të dëgjuar dhe për të vështruar materiale të formave të ndryshme mediatike, mësues/i,-ja mund të përdorë mënyra të tilla, si:

Lexim dhe diskutim në grup i një fragmenti; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të zhvillojë strategjitë e të lexuarit e të reflektojë ndaj tekstit. Gjithashtu, kjo mënyrë bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë strategjitë e të lexuarit dhe aftësitë reflektuese.

Shikim dhe diskutim në grup i një filmi/dokumentari; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen e të zgjerojë mendimet dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë analitike dhe gojore të nxënësit, si dhe mënyrën e aplikimit të njohurive në jetën e përditshme.

Për vlerësimin e aftësive për të përzgjedhur përmes strategjive të ndryshme që kompletojnë projekte individuale dhe në grup, mësues/i,-ja mund të përdorë mënyra të tilla, si:

Krijimi i rubrikës së vlerësimit; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon



nxënësin të mendojë në mënyrë analitike e të njohë mirë standardet për realizimin e projekteve. Gjithashtu, kjo mënyrë bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij analitike, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen mbi standardet e kompletimit të një projekti.

Përcaktimi i temës së projektit; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të bëjë zgjedhje të kuptimshme dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë dhe arsyet e tij përzgjedhëse.

Për vlerësimin e aftësive për të reflektuar mbi tekstin dhe për të mbajtur qëndrime, mësues/i,-ja mund të përdorë mënyra të tilla, si:

Shkrimi i esesë argumentuese; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të përdorë argumentet e të bëjë kërkime për të mbrojtur argumentet e tij. Gjithashtu, kjo mënyrë bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij logjikuëse dhe përdorimin e informacionit të marrë nga tekstet e lexuara.

Debati mbi një temë të caktuar; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të ndërtojë dhe mbrojë qëndrimet e tij me gojë. Gjithashtu, kjo mënyrë bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e tij, për të parashtruar mendimin dhe për ta mbrojtur atë.

Diskutimi në grup mbi qëllimin e autorit/autore; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të punojë me tekstin për të përcaktuar qëllimin e autorit/autore dhe bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë mendimin e tij analitik, si edhe të dëgjuarit aktiv.

Shkrimi i një letre zyrtare; kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të mbajë qëndrim mbi një çështje të mprehtë sociale, të vlerësojë informacione të marra nga burime të ndryshme dhe t'i sintetizojë ato në një letër drejtuar një institucioni. Gjithashtu, kjo mënyrë bën të mundur që mësues/i,-ja të vlerësojë aftësitë e nxënësve për të gjykuar vlefshmërinë, objektivitetin, cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit që ai lexon, dëgjon dhe vështron.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë

saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/e saj me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish a produktesh të tjera, si: shkruan, lexon, vlerëson, zbaton, analizon etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja duhet ta vlerësojë nxënësin jo vetëm për produktin përfundimtar, por për të gjitha hapat e procesit të shkruarit.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiva të veçuar të nxënësve, tek ato një orëshe; teste me alternativa ose zhvillim, ose të llojeve të ndryshme, projekte

kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, ese tematike, projekte kurrikulare, ese të llojeve të ndryshme etj. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësues/i,-ja, nxënësi vetë dhe prindërit e tij/e saj gjejnë informacion të shpejtë dhe të përmbledhur rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit; mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh.: të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja; ai/ ajo u mundëson këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

